



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 113**

**Datë 23 korrik 2014**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr. 462, datë 9.7.2014

Për miratimin e rregullores për regjistrimin e mjeteve lundruese në  
Republikën e Shqipërisë.....

5045

**VENDIM**  
**Nr. 462, datë 9.7.2014**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR  
REGJISTRIMIN E MJETEVE LUNDRUESE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 37-63 e 401, shkronja "a", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9254, datë 15.7.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara, "Për kushtet e regjistrimit të anijeve, 1986", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**RREGULLORE**  
**PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE LUNDRUESE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË<sup>1</sup>**  
Maj 2014

**KREU I**  
**PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimet e kësaj rregulloreje janë:

a) Të sigurojë lidhjen e vërtetë mes shtetit shqiptar dhe anijeve që mbajnë flamurin shqiptar, në mënyrë që të ushtrohet me efikasitet juridiksioni dhe kontrolli i shtetit mbi këto anije;

b) Të përcaktojë një kuadër rregullator të parimeve të përgjithshme dhe procedurave për regjistrimin e të gjithë tipave të anijeve;

c) Eliminimin e barrierave teknike për transferimin e anijeve që mbajnë flamurin e një shteti anëtar të BE-së duke siguruar një nivel të lartë të sigurisë së anijes dhe mbrojtjes së mjedisit detar në përputhje me konventat ndërkombëtare; dhe

ç) Të verifikojë zbatimin efikas të parashkrimeve të mësipërme.

**Neni 2**  
**Fusha e veprimit**

1. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjitha mjeteve lundruese me përjashtim atyre të përmendura në paragrafin 2.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet ndaj:

a) mjeteve lundruese që janë me fuqi motorike nën 76 KF;

b) mjeteve lundruese jomotorrike nën 80 GT ose 80 ton ujëzhvendosje;

c) anijeve ushtarake ose anijeve të transportimit të trupave ushtarakë; si dhe

ç) çdo mjeti lundrues tjetër i zotëruar ose e menaxhuar vetëm për shërbime qeveritare jotregtare;

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këtë rregullore, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

1. Anije mallrash: një anije që nuk është anije pasagjerësh;

2. Anije peshkimi: është mjeti lundrues, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin".

3. Anije qiramarrëse *bareboat*: një anije e regjistruar sipas kreut IX të kësaj rregulloreje;

4. Anijet e pasagjerëve: një anije që mban më shumë se dymbëdhjetë pasagjerë.

a) Pasagjer: çdo person, përveç:

i) kapitenit dhe anëtarëve të ekuipazhit ose personave të tjerë të punësuar ose të angazhuar në çdo pozicion në bordin e anijes në funksionimin e saj; dhe

ii) një fëmijë që është nën një vjeç;

5. Certifikata: nënkupton certifikata, dokumente dhe deklarata përputhshmërie e lëshuar nga autoritetet shtetërore apo të një vendi anëtar të BE-së apo nga ndonjë organizëm i njohur për llogari të tyre në përputhje me konventat dhe për anijet e pasagjerëve të përfshira në udhëtime të brendshme në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të aderuar nga RSH-ja mbi rregullat dhe standardet e sigurisë për anijet e pasagjerëve.

6. Certifikata e çregjistrimit: një ekstrakt i njësuar me të dhënat në Regjistër, të një anije, e cila është çregjistruar nga regjistri i mjeteve lundruese.

<sup>1</sup> Kjo rregullore hartohet në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për kushtet e regjistrimit të anijeve" 1986 aderuar nga RSH me ligjin nr. 9254 datë 15.07.2004, si edhe duke përfshirë plotësisht Rregulloren (EC) No 789/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi transferimin e anijeve të mallrave dhe të pasagjerëve midis regjistrave brenda Komunitetit", Numri CELEX 32004R0789, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, nr. 138, datë 30.04.2004, faqe 19 – 23.

7. Certifikata e ndërtuesit: një certifikatë e nënshkruar nga ndërtuesi i anijes dhe që përmban përlllogaritjet, kategorizimin dhe tonazhin e vërtetë të mjetit lundruar, vlerësuar nga ai, datën dhe vendin e ndërtimit të anijes, dhe nëse ka, emrin e personit ose kompanisë për të cilën u ndërtua anija ose emrin e personit ose kompanisë që iu dorëzua.

8. Certifikata me kontratë *bareboat*: një certifikatë regjistrimi lëshuar një anijeje e cila është regjistruar sipas kreut IX të kësaj rregulloreje.

9. Certifikatë regjistrimi: një certifikatë regjistrimi që i lëshohet një anijeje që është regjistruar sipas kësaj rregulloreje.

10. Konventat: Konventa ndërkombëtare e vitit 1974 për sigurinë e jetës në det ((1974 SOLAS); Konventa ndërkombëtare e vitit 1966 mbi vijat e ngarkesës (LL 66); Konventa ndërkombëtare e vitit 1969 mbi matjen e tonazhit të anijeve, dhe Konventa ndërkombëtare e vitit 1973 për parandalimin e ndotjes nga anijet, e ndryshuar me Protokollin e saj të vitit 1978 (MARPOL 73/78), në versionet e tyre më të fundit, dhe kodet përkatëse me status detyrues të adoptuara në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), së bashku me protokollet dhe ndryshimet e ndodhura dhe versionet e tyre të përditësuara.

11. Kërkesat: do të thotë kërkesat për sigurinë dhe parandalimin e ndotjes në lidhje me ndërtimin dhe pajisjet e anijeve të parashikuara në Konventa dhe për anijet e pasagjerëve të përfshira në udhëtime të brendshme në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të aderuar nga RSH-ja mbi rregullat dhe standardet e sigurisë për anijet e pasagjerëve.

12. Lundrim i brendshëm: do të thotë një udhëtim në zonën detare nga një port i Republikës së Shqipërisë në të njëjtin apo një port tjetër brenda Republikës së Shqipërisë.

13. Lundrim ndërkombëtar: do të thotë një udhëtim nëpërmjet detit nga një port i Republikës së Shqipërisë në një port të një shteti tjetër.

14. Mjet lundruar kënaqësie: një mjet lundruar që vepron në bazë jo tregtare dhe që përdoret vetëm për sport apo kënaqësi.

15. Mjet zhytës lundrimi: çdo mjet lundrimi që përdoret ose është bërë për t'u përdorur nën sipërfaqen e ujërave.

16. Mjete lundruese: çdo mjet lundruar siç përkufizohet në nenin 16 të Kodit Detar.

17. Mjete të vogla lundruese: një mjet lundruar që është më pak se 15 metra gjatësi të përgjithshme dhe është ose ka aplikuar për regjistrim sipas kreut X.

18. Numri i identifikimit: numri unik i identifikimit, caktuar një anijeje në regjistrin përkatës të mjeteve lundruese, e caktuar sipas kësaj rregulloreje;

19. Organizëm i njohur: një organ i njohur në përputhje me nenin 36 të Kodit Detar për të kryer disa

inspektime të autorizuara në mjetet e lundrimit në emër të Administratës Detare Shqiptare.

20. Personi i autorizuar: nënkupton personin e autorizuar nga Administrata Detare Shqiptare në lidhjet me një port jashtë Shqipërisë:

a) Çdo zyrtar i konsullatës shqiptare brenda të cilës është rajoni konsullor i portit; ose

b) Nëse Qeveria e Shqipërisë është përfaqësuar në atë vend me një ambasador, çdo anëtar i stafit zyrtar të ambasadës i emëruar nga ai për qëllimet e kësaj rregulloreje.

21. Pezullim i regjistrimit: nënkupton parandalimin e çdo hyrjeje të dhënash, duke përfshirë edhe fshirjen e një të dhëne që bëhet në regjistër në përputhje me parashikimet e nenit 42 të Kodit Detar.

22. Pronësia përfituese: do të përcaktohet nga referencat për çdo interes përfitues në atë anije, sido të jetë ai (mund të vijë nga administratori ose kujdestari, ose sipas një kontrate apo tjetër lloj), përveç interesit tjetër që vjen nga çdo person si kreditor siç specifikohet në nenin 39 të Kodit Detar.

23. Regjistrimi fillestar: nënkupton regjistrimin fillestar që u bëhet mjeteve lundruese në përputhje me kërkesat e neneve nga 47 deri 50 të Kodit Detar.

## KREU II ORGANIZIMI I REGJISTRIT

### Neni 4 Kompetenca

Drejtoria e Përgjithshme Detare është organi i ngarkuar me ligj për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe si rrjedhim organizimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Shqiptar.

### Neni 5 Zyra e Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare e siguron zbatimin e kësaj rregulloreje nëpërmjet Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve.

2. Zyra e Regjistrimit të Mjeteve Lundruese Shqiptare, që më poshtë do të quhet "Regjistri", përfaqësohet nga regjistruesi.

3. Regjistri është unik, me statusin e regjistrimit publik në kuptim të Kodit Civil.

4. Funkcionet e Regjistrimit realizohen nëpërmjet inspektorëve, ndër të cilët janë dhe mbikëqyrësit e anijeve.

5. Regjistri shërben për:

a) mbajtjen e regjistrimit të mjeteve lundruese dhe regjistrimin, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore;

b) pasqyrimin e hipotekës dhe të privilegjeve në pronësinë e tyre ose raste të tjera të përcaktuara në këtë rregullore;

c) njohjen e së drejtës të dhënies së flamurit, përcaktimin e shenjave dalluese të mjetit lundrues;

ç) regjistrimin e emrit të mjetit dhe numrit unik të identifikimit;

d) dhënien e certifikatave për veprimet e regjistrimit.

#### Neni 6 Regjistrat

6. Regjistrat e mjeteve lundruese do të jenë fizikë (në letër) dhe elektronikë, dhe do të jenë si më poshtë:

a) Regjistri i mjeteve lundruese të transportit të mallrave dhe pasagjerëve;

b) Regjistri i mjeteve lundruese të peshkimit;

c) Regjistri i mjeteve lundruese në ndërtim;

ç) Regjistri i mjeteve lundruese të kërkimeve shkencore;

d) Regjistri i mjeteve lundruese të shërbimeve portuale;

e) Regjistri i mjeteve lundruese me kontratë “bareboat”;

f) Regjistri i mjeteve lundruese të vogla.

7. Ministri përgjegjës për transportin dhe ministritë e tjera përkatëse, bashkërisht, mund të përjashtojnë mjetet të vogla lundruese lokale dhe të ndërtuara nga zëjtare lokalë nga përputhshmëria me dispozitat të tjera që zbatohen ndaj regjistrimit të mjeteve lundruese.

#### Neni 7

##### Kriteret e përgjithshme të regjistrimit sipas pronësisë

1. Mund të regjistrohen në Regjistër të gjitha mjetet lundruese, që janë:

a) pronë publike shqiptare;

b) pronë e subjekteve fizike vendase, anëtare të BE-së ose jo, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

c) pronë e personit juridik, vendas, në shtetet anëtare të BE-së ose jo, të regjistruara në Shqipëri;

ç) pronë e një personi fizik ose juridik në shtetet anëtare të BE-së ose jo, me banim ose regjistrim në shtetet anëtare të BE-së ose jo, me përfaqësues të përhershëm në Shqipëri, me prokurë të posaçme për të pranuar reklamime drejtuar pronarit të anijes;

d) me qira “bareboat” tek operatorët/nënshtetasit shqiptarë.

2. Regjistrimet në Regjistër duhet të bëhen në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

a) Pronësia e një anijeje mund të ndahet në 64 pjesë. Nuk lejohet regjistrimi në të njëjtën kohë i më shumë se 64 personave fizikë ose juridikë si pronarë të një anije;

b) Në varësi të dispozitave të kësaj rregulloreje në lidhje me pronarët e përbashkët ose pronarët me transferim, jo më shumë se 5 persona do të kenë të drejtë të regjistrohen në të njëjtën kohë si pronarë të çdo lloji anijeje. Ky rregull nuk do të ndikojë të drejtën përfituese të

çdo personi të përfaqësuar ose pretendues sipas ose nëpërmjet çdo pronari të regjistruar apo bashkëpronari;

c) Një person nuk do të ketë të drejtë të regjistrohet si pronar i një pjese të një kuote; por çdo numër personash jo më shumë se pesë mund të regjistrohet si bashkëpronar të një anijeje ose të çdo kuote apo kuotave të një anijeje;

ç) Bashkëpronarët do të konsiderohen si person i vetëm vetëm përsa u përket personave që kanë të drejtën të regjistrohen, dhe nuk do të kenë të drejtën të disponojë në individualitet në ndonjë interes në anije, ose në ndonjë kuotë në anije, në lidhje me anijen për të cilën janë regjistruar.

### KREU III KUALIFIKIMI PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE LUNDRUESE

#### SEKSIONI 1 MJETET E LUNDRIMIT PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE DHE TË PASAGJERËVE

#### Neni 8

##### Pronarët e anijeve për regjistrim

1. Personat e mëposhtëm janë të kualifikuar të jenë pronarët e anijeve që do të regjistrohen në Regjistrin e Mjeteve të Lundrimit për Transportin e Mallrave dhe të Pasagjerëve janë:

a) pronarë publikë shqiptarë;

b) pronarë të subjekteve fizike vendase, shtetas të BE-së ose jo, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;

c) pronarë si person juridik vendas, në shtetet anëtare të BE-së ose jo, të regjistruara në Shqipëri;

ç) pronarë si një person fizik ose juridik në shtetet anëtare të BE-së ose jo, me banim ose regjistrim në shtetet anëtare të BE-së ose jo, me përfaqësues të përhershëm në Shqipëri, me prokurë të posaçme për të pranuar reklamime drejtuar pronarit të anijes.

#### Neni 9

##### Shumica shqiptare e kuotave

1. Një anije do të ketë të drejtë të regjistrohet nëse shumica e kuotave të anijes zotërohet nga një ose më shumë persona të kualifikuar për të qenë pronarë të anijeve shqiptare.

#### SEKSIONI 2 MJETET LUNDRUESE PËR PESHKIM

#### Neni 10

##### Pronarët e anijeve për regjistrim të mjeteve lundruese për peshkim

Personat e mëposhtëm janë të kualifikuar të jenë pronarë të anijeve të peshkimit që të regjistrohen në Regjistër:

a) pronë publike shqiptare;

b) pronë e subjekteve fizike vendase të zotëruar nga shtetas shqiptarë;

c) pronë e personit juridik, vendas, ku pjesa e kapitalit të zotëruar nga shtetasit shqiptarë të jetë së paku 51 për qind.

#### Neni 11

##### **Personat përfaqësues për anijet e peshkimit**

1. Pavarësisht nga plotësimi i kërkesave të specifikuara në nenin 10, një anije nuk duhet të regjistrohet nëse nuk:

a) menaxhohet, dhe veprimet e saj kontrollohen dhe drejtohen nga brenda Shqipërisë; dhe

b) kualifikohet si një person për të qenë pronar i një anijeje peshkimi shqiptare çdo kontraktues, menaxher ose operator i anijes sipas nenit 10.

#### KREU IV

##### **CAKTIMI I PERSONAVE PËRFAQËSUES**

#### Neni 12

##### **Caktimi i personave përfaqësues**

1. Kur e drejta për regjistrim e një anijeje varet nga caktimi i një përfaqësuesi, pronari i anijes duhet:

a) përpara aplikimit për regjistrimin e anijes, të caktojë një individ ose një degë kompanie që plotëson kërkesat e paragrafit 2 më poshtë për të qenë përfaqësues; dhe

b) të sigurojë që, për sa kohë anija ngelet e regjistruar, do të jetë caktuar një individ ose degë e kompanisë që plotëson këto kërkesa.

2. Një person përfaqësues është:

a) një person fizik me banim në përhershëm në Shqipëri; ose

b) një person juridik i regjistruar në Shqipëri.

3. Caktimi i personit përfaqësues do të bëhet me anë të një prokure të posaçme, e cila, ndër të tjera, duhet të jetë në formë dhe përmbajtje të pranuar nga regjistrimi.

4. Në rast të ndonjë ndryshimi në identitetin ose adresën e personit përfaqësues, të njoftojë regjistrimin për ndryshimin përkatës brenda 7 ditëve.

#### KREU V REGJISTRIMI

#### Neni 13

##### **Procesi i aplikimit**

Çdo aplikim i bërë sipas këtij kreu do të kryhet pranë regjistrimit të anijeve sipas formularit të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

#### Neni 14

##### **Aplikuesi**

Aplikimi për regjistrimin e mjeteve lundruese pranë Regjistrimit sipas kësaj rregulloreje do të kryhet nga vetë pronari ose personi i autorizuar prej tij.

#### Neni 15

##### **Dokumentet e nevojshme për vërtetimin e pronësisë**

1. Çdo aplikim për regjistrim sipas kësaj rregulloreje duhet të mbështetet nga një deklaratë personale dhe evidencat dokumentare si më poshtë:

a) Evidencë dokumentare (kontratë shitblerjeje, faturë shitjeje, "Bill of Sale", etj.) për çdo pronar ku caktohen kuotat e tij/tyre në mjetin lundrues;

b) Ekstrakt i QKR-së, ku tregohen numri i aksioneve në mjetin lundrues, si dhe përfaqësuesin(it) ligjor; dhe

c) Statusin e kompanisë.

2. Aplikimi për regjistrimin e një anijeje, e cila para aplikimit, është regjistruar në një regjistër tjetër, duhet të shoqërohet me një ekstrakt të regjistrimit ekzistues.

#### Neni 16

##### **Aplikimet nga kompanitë dhe degët e tyre**

1. Kur aplikimi bëhet në emër të një kompanie apo dege të saj, aplikimi duhet të shoqërohet nga:

a) Nëse ajo është një shoqëri vendase, shoqëri në shtetet anëtare të BE-së ose jo, e regjistruar në Shqipëri ose jo, një kopje të QKR-së së përfaqësuesit, përfshirë edhe për ndryshime të emrit të saj;

b) Nëse është një degë e një kompanie në një shtet anëtar të BE-së ose jo, prova në përputhje me ligjet e atij vendi që kjo kompani është një degë e shoqërisë përkatëse.

#### Neni 17

##### **Deklarimi i synimit për regjistrim të mjetit lundrues**

1. Nëse, në kohën kur bëhet aplikimi, pronësia e anijes nuk ka kaluar akoma (ose plotësisht) tek personat që do të bëhen pronarët e saj kur të regjistrohet, aplikimi do të shoqërohet nga një deklaratë synimi në vend të një deklarate vërtetimi.

2. Kjo deklaratë do përbëhet nga:

a) një projektdeklaratë vërtetësie, duke paraqitur veçantitë e pronësisë së anijes që synojnë të regjistrojnë me përfitimin e plotë të pronësisë; dhe

b) një deklaratë që pronësia e anijes, në kohën kur të bëhet regjistrimi, do të jetë siç shprehet në projektdeklaratën e paraqitur.

#### Neni 18

##### **Regjistrimi fillestar i mjeteve lundruese**

1. Për regjistrimin fillestar të mjeteve lundruese, aplikuesi/pronari duhet të paraqesë pranë regjistrimit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Aplikimi për regjistrim - shtojca II, i plotësuar si duhet;

b) Përfitimi i pronësisë:

- Evidencë dokumentare (kontratë shitblerjeje, faturë shitjeje, "Bill of Sale", etj.) për çdo pronar ku caktohen kuotat e tij/tyre në mjetin lundrues;

- Ekstrakt i QKR-së, ku tregohen numri i aksioneve në mjetin lundrues, si dhe përfaqësuesin ligjor; dhe

- Statusin e kompanisë.

2. Për ndërtimet e reja, në vend të faturës së shitjes, një certifikatë e ndërtuesit dhe certifikatat nga shoqëria klasifikuese /ONJ që ndjek ndërtimin e saj.

3. Të dhënat për pronarin e anijes:

a) Për pronarët me nënshtetësi shqiptare - fotokopje të pasaportës, ku të dhënat të jenë të njëjta si te formati i aplikimit;

b) Për pronarët me nënshtetësi të huaj - fotokopje të pasaportës, ku të dhënat të jenë të njëjta si tek formati i aplikimit;

c) Për kompanitë shqiptare – ekstrakt i QKR-së;

ç) Për përfaqësuesit e pronarit – prokura e posaçme.

4. Certifikatën e tonazhit (ITC 1969) dhe certifikatat statutore të lëshuar nga ONJ.

5. Kopje të pasqyrës së fundit të vijueshmërisë historike (CSR) – kur aplikohet kodi ISPS.

6. Certifikatë çregjistrimi/ose deklaratë nga titullari i regjistrit ekzistues, ku thuhet se çregjistrimi i kësaj anijeje është në proces.

7. Me marrjen e këtyre dokumenteve, regjistri lëshon certifikatën e përkohshme të regjistrimit sipas shtojcës 4, e cila ka një afat vlefshmërie prej 90 ditësh, kohë kjo për të mundësuar mbylljen e procedurave të çregjistrimit nga regjistri i mëparshëm dhe paraqitjen e dokumentacionit origjinal pranë regjistrit.

Neni 19

#### **Emrat**

1. Kur bëhet një aplikim për regjistrimin e anijes, aplikuesi duhet të propozojë një emër me të cilën anija do të thirret.

2. Emrat e anijes duhet të jenë në përputhje me kërkesat e shtojcës I.

3. Asnjë ndryshim nuk do të bëhet në emrin e regjistruar të anijes pa lejen me shkrim të Regjistrit.

Neni 20

#### **Përcaktimi i numrit unik të identifikimit dhe portit të regjistrimit**

Me regjistrimin e anijes në regjistrin përkatës asaj do t'i jepet një numër unik zyrtar identifikimi. Këtij numri do t'i referohen të gjitha certifikatat e anijes që lëshohen në emër të Republikës së Shqipërisë. Formula për këtë numër është si më poshtë:

- Dy shifrat e fundit të vitit të regjistrimit; dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit; kodi i llojit të anijes –numri rendor treshifror në regjistrin përkatës;

P.sh.: një anije pasagjere e regjistruar në vitin 2009, e prodhuar në vitin 1996, me nr. rendor të regjistrit 032, do të ketë këtë numër zyrtar regjistrimi: 0996-20-032.

Kodet e anijeve sipas tipit të tyre për efekt regjistrimi

Kodet e anijeve sipas tipit të tyre janë:

a) 10 - mjete lundruese të transportit të ngarkesave;

b) 20 - mjete lundruese të transportit të pasagjerëve;

c) 30 - mjete lundruese të shërbimeve portuale;

ç) 40 - mjete lundruese të peshkimit;

d) 50 - mjete lundruese të kërkimeve shkencore;

e) 60 - Mjete lundruese me kontratë "bareboat".

1. Për të gjitha anijet që regjistrohen në Regjistrin Shqiptar të Anijeve, porti i regjistrimit do të jetë – DURRËS.

Neni 21

#### **Shënjimi**

Me regjistrimin e mjetit lundrues për herë të parë pronari duhet:

a) të bëjë gdhendjet dhe shënimet përkatëse sipas kërkesave të Konventës për "Vijat e ngarkesës "66", e ndryshuar dhe kodit ISPS për numrin e IMO-s;

b) nëse kërkohet, të lejojë inspektimin nga inspektorët e autorizuar nga Regjistri për verifikimin e gdhendjeve dhe shenjzimit.

Neni 22

#### **Tonazhet e anijes**

1. Përpara regjistrimit, mjeti lundrues kontrollon për saktësinë e tonazhit, sipas dokumenteve të paraqitura nga pronari, dhe në Regjistër shënohet tonazhi faktik me shënimet për diferencat e rezultuara.

2. Së bashku me përlllogaritjen e tonazhit, Regjistrit duhet t'i paraqitet një dokument ku të specifikohen veçoritë dhe përshkrimi i identitetit të anijes sipas shtojcave të kësaj rregulloreje.

3. Rregullat për t'u siguruar për tonazhin e anijes duhet të jenë sipas Rregullores së Tonazhit, e cila përfshin edhe inspektimin e anijes për të konfirmuar informacionin e futur në përlllogaritje dhe parametrat e përfshirë në dokumentin e përmendur në paragrafin 2.

Neni 23

#### **Regjistrimi dhe mospranimi i regjistrimit të një anijeje**

1. Nëse regjistri sigurohet përse i përket një aplikimi që:

a) anija ka të drejtë të regjistrohet si anije shqiptare; dhe  
b) anija është gdhendur dhe shënuar siç duhet, përlllogaritjet e tonazhit ose certifikata e tonazhit dhe certifikatat statutore janë siguruar; dhe

c) veçoritë e dhëna të anijes janë të sakta; dhe

ç) titulli i pronësisë së anijes është provuar në mënyrë të përshtatshme (sipas rastit); dhe

d) certifikata e çregjistrimit/ose deklaratë nga titullari i regjistrit ekzistues ku thuhet se çregjistrimi i kësaj anijeje është në proces; dhe

e) kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje janë përmbushur, regjistri do të regjistrojë anijen në Regjistër me veçoritë dhe pronarët e saj të specifikuar në shtojcën III.

2. Regjistri, kur nuk plotësohen kërkesat në paragrafin 1, mund të mos pranojë të regjistrojë mjetin lundruar, dhe kërkon informacione sipas nenit 87.

3. Pavarësisht se një anije ka drejtë të regjistrohet sipas kritereve të përmendura më lart, regjistri mund të refuzojë ta regjistrojë atë, duke marrë në konsideratë çdo kërkesë në lidhje me kushtet e anijes ose pajisjeve të saj përsa i përket sigurisë apo rrezikut të ndotjes, apo sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së personave të punësuar apo të angazhuar në bordin e anijes, dhe e konsideron që regjistrimi i anijes do të ishte i pavend.

#### Neni 24

##### **Lëshimi i certifikatës së regjistrimit**

Pas regjistrimit, regjistri do të lëshojë dhe do t'i dorëzojë pronarit një certifikatë regjistrimi që përmban veçoritë e përcaktuara në shtojcën V.

#### Neni 25

##### **Periudha e regjistrimit**

Regjistrimi i anijes do të jetë i vlefshëm për një periudhë 5-vjeçare që fillon me datën e regjistrimit të specifikuar në certifikatën e regjistrimit dhe do të mbarojë në fund të kësaj periudhe, përveçse kur rinovohet në përputhje me nenin 27 (aplikimi për rinovimin e regjistrimit).

#### Neni 26

##### **Njoftimet dhe afati për rinovimin**

1. Tre muaj përpara mbarimit të afatit të regjistrimit, regjistri do të njoftojë pronarin e anijes për rinovimin e regjistrimit.

2. Aplikimi për rinovimin e regjistrimit mund të bëhet gjatë tre muajve të fundit kalendarikë të afatit aktual të regjistrimit.

#### Neni 27

##### **Aplikimi për rinovimin e regjistrimit**

1. Aplikimi për rinovim do të bëhet sipas shtojcës II dhe do të shoqërohet nga:

a) një deklaratë që nuk ka pasur asnjë ndryshim ose për çdo ndryshim në ndonjë nga detajet e regjistrimit të anijes, formularin sipas shtojcës VIII.

2. Nëse nuk bëhet një aplikim për rinovim, Regjistri do të njoftojë çdo kreditor për përfundimin e afatit të regjistrimit të anijes.

#### Neni 28

##### **Provimi i titullit (të pronësisë) në regjistrimin e transferimit të anijes**

1. Në aplikimin për regjistrim të transferimit të një anijeje të regjistruar ose kuota të një anijeje të regjistruar, Regjistrit duhet t'i paraqitet fatura e shitjes.

#### Neni 29

##### **Fatura e shitjes**

Çdo faturë shitjeje që përcakton ndryshimin e pronësisë së një anijeje të regjistruar ose kuota të një anijeje sipas këtij kreu duhet të përmbajë një përshkrim të anijes mjaftueshëm për ta identifikuar atë, që pranohet nga Regjistri.

#### Neni 30

##### **Regjistrimi i transferimit të anijes**

1. Nëse Regjistri miraton aplikimin e transferimit të anijes ose kuotave të një anijeje, ajo duhet:

a) të regjistrojë faturën e shitjes duke regjistruar emrin e pronarit të ri në Regjistër si pronari i anijes apo kuotave në fjalë, dhe

b) të shënojë te fatura e shitjes, faktin që regjistrimi është bërë, së bashku me kohën dhe vendin kur është bërë.

2. Nëse regjistri sigurohet me prova sipas nenit 31, që anija ose kuotat në një anijeje janë transferuar, ajo do të regjistrojë emrin e pronarëve të rinj në Regjistër si pronari i anijes apo kuotave në fjalë dhe të lëshojë një certifikatë e re, e cila do të jetë e vlefshme për një periudhë prej 5 vjetësh.

#### Neni 31

##### **Provimi i pronësisë në transferimin (kalimin) e një anijeje të regjistruar**

1. Një aplikim për regjistrimin e transferimit të një anijeje të regjistruar ose kuotash në një anije të regjistruar duhet të bëhet sipas shtojcës II.

2. Evidenca e mëposhtme do t'i jepet Regjistrit për një aplikim për transferimin e një anijeje të regjistruar ose kuotave nëpërmjet transferimit:

a) Nëse transferimi (kalimi) ishte pasojë e vdekjes, të drejtën e lindur nga dëshmia e trashëgimisë;

b) Nëse transferimi ishte pasojë e falimentimit, vendimi i gjykatës ose i autoriteteve përkatëse lidhur me falimentimin;

c) Nëse transferimi ishte pasojë e një urdhri të gjykatës, një kopje të urdhrorit ose vendimit të gjykatës.

#### Neni 32

##### **Refuzimi i regjistrimit të transferimit ose të kalimit**

1. Nëse nuk plotësohen kërkesat e një aplikimi për transferimin ose kalimin e një anijeje ose kuotave të saj, Regjistri refuzon regjistrimin duke:

a) njoftuar sipas paragrafit 2 pronarin e anijes; dhe

b) mbyllur regjistrimin e anijes mbështetur në këtë paragraf në fund të një afati prej 14 ditësh që fillon me datën e dhënies së njoftimit.

2. Një njoftim sipas këtij paragrafi do të konsistojë:

a) që Regjistri nuk është i bindur që anija në fjalë ka të drejtë të regjistrohet; dhe

b) që regjistrimi i anijes do të mbyllet në fund të afatit të parashikuar në paragrafin 1 germa “b”.

#### Neni 33

##### **Transferimi i një anijeje ose kuotash të një anijeje**

Nëse ndodh një transferim apo kalim të një anijeje të regjistruar ose kuotash në një anije të regjistruar:

a) Personi që pushon së qeni pronari i anijes apo kuotave të një anijeje, ose në rastin e vdekjes së tij, përfaqësuesi i tij ligjor, duhet të njoftojë regjistrin dhe të dorëzojë certifikatën e regjistrimit; dhe

b) Regjistri do të anulohet certifikatën e regjistrimit dhe do të pezullojë regjistrimin në varësi të transferimit apo kalimit nga pronari ose pronarët e anijes apo kuotave të saj.

#### Neni 34

##### **Pronarët e rinj për shkak të transferimit të një anijeje të regjistruar apo kuotave**

1. Në rastin e transferimit të një anijeje të regjistruar, që transferta të regjistrohet, pronarët e rinj, brenda 30 ditësh nga transferimi duhet të aplikojnë në përputhje me këtë rregullore.

2. Nëse transferta është për të gjitha kuotat e anijes dhe aplikimi nuk bëhet brenda 30 ditësh, regjistrimi mund të pezullojë regjistrin e kësaj anije dhe kërkon certifikatën e regjistrimit.

3. Nëse transferta është bërë për një ose disa kuota në një anije dhe aplikimi nuk bëhet brenda 30 ditëve, Regjistri duhet të njoftojë pronarët e tjerë të regjistruar që nëse një aplikim për transferimin e kuotës ose kuotave në fjalë nuk bëhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, regjistrimi i anijes dhe certifikata e regjistrimit do të anulohet.

#### Neni 35

##### **Ndryshimet në veçoritë e regjistruara të anijes**

1. Nëse ndodhin ndryshime të:

a) veçorive të regjistruara të anijes, të ndryshme nga ndryshimi i tonazhit të anijes; ose

b) në emrin ose adresën e pronarit të regjistruar në Regjistër (duke mos qenë një ndryshim në pronësi), që ndryshimet të pasqyrohen në Regjistër duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur aplikimi pranë Regjistrin.

2. Një aplikim i tillë do të bëhet me shkrim dhe do të shoqërohet me certifikatën e regjistrimit dhe prova për ndryshimin, siç mund të kërkohej nga Regjistri.

3. Atje ku ka ndryshim në tonazhin e anijes, ajo do të bëhet objekt i përlllogaritjeve ose rimatjeve të reja të tonazhit në përputhje me nenin 22 (tonazhet e anijes).

4. Aplikimi sipas shtojcës VIII do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që ndryshimi të pasqyrohet në Regjistër. Aplikimi duhet të shoqërohet

nga përlllogaritjet ose certifikata e tonazhit dhe certifikata e Regjistrimit.

5. Gjatë regjistrimit të ndryshimit në veçoritë e regjistrimit, Regjistri duhet të anulohet certifikatën ekzistuese dhe t'i lëshojë pronarit një certifikatë të re regjistrimi që mbaron në të njëjtën datë si ajo ekzistuese.

#### Neni 36

##### **Ndryshimi i emrit**

1. Një pronar i një anijeje të regjistruar mund të aplikojë pranë Regjistrin për ndryshimin e emrit të anijes. Aplikimi duhet të bëhet sipas shtojcës VIII dhe do të shoqërohet nga certifikata e regjistrimit.

2. Nëse Regjistri sigurohet që emri është në përputhje me shtojcën I (miratimi i emrave), ajo do njoftojë pronarin për gdhendjet dhe shënjimet.

3. Me marrjen e njoftimit të gdhendjes të plotësuar në mënyrën e duhur, Regjistri do të reregjistrojë anijen me emrin e ri dhe do të anulohet certifikatën ekzistuese, dhe do t'i lëshojë pronarit një certifikatë të re regjistrimi që skadon në të njëjtën ditë si ajo ekzistuese.

#### Neni 37

##### **Heqja nga regjistri**

1. Regjistri, në varësi të nenit 82 (njoftimet) mund të mbyllë regjistrimin e një anijeje në rrethanat e mëposhtme:

a) Me kërkesën e pronarit;

b) Kur anija humbet të drejtën të regjistrohet;

c) Me shkatërrimin e anijes (që përfshin, por nuk kufizohet në, mbytjen e anijes, shkatërrimin, djegien dhe skrapimin);

ç) Nëse e gjykon që regjistrimi i anijes do të ishte i pavend duke marrë parasysh kërkesat në lidhje me kushtet që një anije ose pajisjet e saj për sa i përket sigurisë apo rrezikut të ndotjes, apo sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së personave të punësuar apo të angazhuar në bordin e anijes;

d) Me mospërfitimin e certifikatave përkatëse të lëshuara nga shoqëria e klasifikimit (ONJ).

2. Nëse Regjistri mbyll regjistrimin sipas pikave në paragrafin 1 më sipër, ajo duhet:

a) menjëherë t'i lëshojë një transkript të mbylljes së regjistrimit pronarit të anijes; dhe

b) të njoftojë çdo kreditor për mbylljen e regjistrimit.

3. Me marrjen e transkriptit të mbylljes së regjistrimit, pronari menjëherë duhet të dorëzojë certifikatën e regjistrimit të anijes Regjistrin për anulim.



**KREU VI  
HIPOTEKA DHE BARRËT SIGURUESE  
FINANCIARE**

Neni 38

**Regjistrimi i hipotekave dhe i barrëve siguroese  
financiare**

1. Nëse vendoset hipotekë ose barrë siguroese financiare, kreditori dhe debitori duhet të aplikojnë pranë Regjistrimit për regjistrim.

2. Kur hipoteka ose barra siguroese financiare paraqitet te Regjistri për regjistrim, ajo duhet:

- a) të regjistrojë hipotekën ose barrën siguroese financiare; dhe
- b) ta vërtetojë atë me kohën dhe vendin ku është regjistruar.

Neni 39

**Formulari i hipotekave dhe barrëve siguroese  
financiare**

Një formular i pranuar nga Regjistri, në çdo rast i pajisur me dokumentacionin përkatës, do të përdoret kur bëhet një:

- a) regjistrim për hipotekim ose barrë siguroese financiare;
- b) transferim i një hipoteke ose barre siguroese financiare të regjistruar; dhe
- c) shlyerje e hipotekës ose barrës siguroese financiare të regjistruar.

Neni 40

**Njoftimi nga kreditorët e ardhshëm**

1. Kur një person që do të bëhet kreditor sipas një propozimi për hipotekim ose barrë siguroese financiare të:

- a) një anije të regjistruar; ose
- b) një kuote në një anije të regjistruar, njofton regjistrin, dhe kjo e fundit do të regjistrojë këtë interesim.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, njoftimi për regjistrin duhet të bëhet sipas një formularit të pranuar dhe minimalisht do të përmbajë emrin dhe numrin zyrtar të anijes, adresën dhe nënshkrimin e debitorit të ardhshëm, numrin e kuotave për t'u lënë peng dhe emrin dhe adresën e kreditorit të ardhshëm.

Neni 41

**Formulari i njoftimit**

Për qëllimet e nenit 82, njoftimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) Emrin e tanishëm të anijes;
- b) Emrin e planifikuar të anijes;
- c) Të dhënat e përgjithshme të anijes;
- ç) Nëse anija është regjistruar jashtë Shqipërisë, një kopje të certifikatës së regjistrimit ose çdo dokument

5052

tjetër që provon regjistrimin e saj dhe portin e saj të regjistrimit;

d) Nëse anija është një anije e re, certifikatën e ndërtuesit ose nëse ajo nuk është e mundur, emrin dhe adresën e ndërtuesit dhe numrin e kantierit të anijes;

e) Nëse anija nuk është një anije e re ose një anije e regjistruar, detaje të çdo shënjimi të përhershëm në anije e cila e bën atë qartësisht të identifikueshme;

f) Emrin, adresën dhe nënshkrimin e debitorit të ardhshëm, numrin e kuotave për t'u lënë hipotekë ose barrë siguroese financiare, dhe emrin dhe adresën e kreditorit të ardhshëm.

Neni 42

**Precedenca e hipotekave dhe barrëve siguroese  
financiare të regjistruara**

Nëse dy ose më shumë hipoteka ose barra siguroese financiare janë regjistruar për një anije të vetme ose kuotë, precedenca e hipotekave dhe barrëve siguroese financiare mes vetë atyre do të vendoset nga rendi në të cilën janë regjistruar ato (dhe jo nga referimi ndaj ndonjë çështjeje tjetër).

Neni 43

**Dëshmi të transferimit ose kalimit të hipotekave dhe  
barrëve siguroese financiare**

Një hipotekë ose një barrë siguroese financiare e regjistruar e cila transferohet, ose interesi në të transmetohet, do të transferohet në një formular të pranuar nga Regjistri.

Neni 44

**Transferimi ose kalimi i hipotekave dhe barrëve  
siguroese financiare të regjistruara**

1. Nëse ndodh një kalim ose transferim i një hipoteke ose barre siguroese financiare të regjistruar, Regjistri:

a) duhet të regjistrojë emrin dhe transferuesin në Regjistrin si kreditor të anijes apo kuotave në fjalë; dhe

b) duhet të bëjë shënimin te dokumenti për datën dhe kohën kur bëhet regjistrimi.

2. Në një aplikim për regjistrimin e një transferimi të një hipoteke ose barrë siguroese financiare të regjistruar, provat për Regjistrin do të jenë të njëjtat si ata të kërkuara nga neni 31 (Provat e titullit në transferimin e një anijeje të regjistruar).

Neni 45

**Heqja e hipotekave dhe barrëve siguroese financiare**

1. Kur hipoteka ose barra siguroese financiare shlyhet, Regjistri, me paraqitjen e kreditorit dhe me prova të kënaqshme që hipoteka ose barra siguroese financiare është hequr, duhet të regjistrojë në Regjistrin që hipoteka ose barra siguroese financiare është shlyer.

Neni 46

**Efekti i mbarimit të regjistrimit mbi hipotekat dhe barrët siguruese financiare të regjistruara**

Nëse regjistrimi i një anijeje përfundon sipas çdonjërit nga këto nene, kjo mbyllje nuk do të ndikojë në ndonjë regjistrim në Regjistër të çdo hipoteke ose barre siguruese financiare të regjistruar të pashlyer të asaj anijeje apo kuotave të saj.

**KREU VII  
REGJISTRIMI I PËRKOHSHËM**

Neni 47

**Aplikimi për regjistrim të përkohshëm**

Aplikim për regjistrim të përkohshëm do të bëhet sipas shtojcës II dhe do të shoqërohet nga veçoritë e kërkuara nga neni 14 (aplikuesi) dhe neni 16 (aplikimet nga kompanitë dhe degët e tyre).

Neni 48

**Periudha e regjistrimit të përkohshëm**

Regjistri, me sigurinë që anija ka të drejtë të regjistrohet, mund të procedojë në regjistrimin e anijes përkohësisht për një periudhë deri në 90 ditëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të duhur për regjistrim të përhershëm.

Neni 49

**Certifikata e regjistrimit të përkohshëm**

1. Regjistri do t'i lëshojë pronarit të anijes një certifikatë regjistrimi të përkohshëm sipas shtojcës IV;

2. Certifikata do të ketë atributet e një certifikate regjistrimi deri në:

- a) skadimin e 90 ditëve nga data e lëshimit; ose
- b) mbërritjen e anijes në Shqipëri, ose
- c) me kërkesë të pronarit, shkurtimin e kohës së regjistrimit të përkohshëm dhe duke aplikuar për regjistrim të përhershëm.

Neni 50

**Regjistrimi i përkohshëm jo për t'u rinovuar**

Nëse pronari i anijes paraqet evidenca dokumentare dhe argumente bindëse para Regjistrimit për mosplotësimin brenda 90 ditëve të dokumentacionit për regjistrim të përhershëm të mjetit lundrues, Regjistri rezervon të drejtën e zgjatjes së afatit të regjistrimit të përkohshëm për 90 ditë të tjera pas skadimit të periudhës së parë, duke e konsideruar këtë regjistrim të përkohshëm si përfundimtar.

Neni 51

**Kushti i regjistrimit të përkohshëm për anijet e peshkimit**

Do të jetë kusht për regjistrimin e përkohshëm të anijeve të peshkimit që anija nuk do të peshkojë për

përfitim nëse është regjistruar si e tillë; dhe nëse një anije e tillë e regjistruar përkohësisht peshkon për përfitim, regjistrimi i saj i përkohshëm do të përfundojë menjëherë dhe pronarit të saj do t'i kërkohej të dorëzojë menjëherë certifikatën e regjistrimit të përkohshëm tek Regjistri.

**KREU VIII  
MOSHA DHE DISA VEÇORI TEKNIKE TË  
MJETEVE LUNDRUESE PËR REGJISTRIM**

Neni 52

**Fusha e zbatimit**

1. Ky kapitull do të zbatohet ndaj:

a) anijeve të mallrave, që kanë certifikata të vlefshme, të cilat:

i) janë ndërtuar jo më parë se 30 vjet nga data e aplikimit për regjistrim; ose

ii) janë ndërtuar më përpara, por janë certifikuar nga një vend anëtar i BE-së ose nga një organizëm i njohur që vepron në emër të saj në përputhje me rregulloret për anijet e reja të përcaktuara në 1974 SOLAS, ose, në rastin e anijeve naftëmbajtëse e anijeve transportimit të substancave kimike, me kodet standarde përkatëse për anijet e ndërtuara jo më parë se 30 vjet nga data e aplikimit për regjistrim;

b) anije të pasagjerëve, të angazhuara në udhëtime kombëtare dhe/ose ndërkombëtare, që kanë certifikata të vlefshme, të cilat:

i) janë ndërtuar jo më parë se 30 vjet nga data e aplikimit për regjistrim, ose

ii) janë ndërtuar më përpara asaj date, por janë certifikuar nga një Shtet Anëtar ose nga një organizëm i njohur që vepron në emër të tij në përputhje me kërkesat e vendosura për anijet pasagjere:

- Në standardet e sigurisë së BE-së, për anijet e angazhuara në udhëtime të brendshme;

- Në 1974 SOLAS, për anijet e angazhuara në udhëtime ndërkombëtare.

2. Ky kapitull nuk do të zbatohet ndaj:

a) anijeve pas dorëzimit nga përfundimi i ndërtimit të tyre që nuk kanë certifikata me cikël të plotë klasifikimi të vlefshme nga Shteti Anëtar i BE-së nga ku ka humbur regjistrimin;

b) anijeve që u është refuzuar hyrja në portet e Shteteve Anëtare të BE-së në përputhje me rregulloret e zbatueshme në inspektimet e kontrolleve shtetërore portuale, gjatë tre vjetëve përpara aplikimit për regjistrim dhe anijeve që janë ndaluar pas një inspektimi në një port të një vendi nënshkrues të Memorandumit të Mirëkuptimit në 1982 në Paris mbi kontrollin shtetëror portual ose të analogeve në rajone të tjera të botës (p.sh. Memorandumi i Detit të Zi, Mesdheut, Tokios, etj.) dhe për arsye që lidhen me kërkesat e përcaktuara në nenin 3 (11) më shumë se njëherë gjatë tre vjetëve përpara aplikimit për regjistrim;

c) anijeve të luftës ose transportimit të trupave, ose anijeve të tjera të zotëruara ose të operuara nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe të përdorura vetëm për shërbime qeveritare jotregtare;

ç) anijeve që nuk kanë shtytje me mjete mekanike, anijeve të drunjta apo primitive, jahtet që nuk përfshihen në tregti ose anijet e peshkimit;

d) mjeteve lundruese që janë me fuqi motorrike nën 76 KF;

dh) mjeteve lundruese me jomotorrike nën 80 GT ose 80 ton ujëzhvendosje;

#### Neni 53

### Regjistrimi me kusht i anijes

1. Regjistri nuk do refuzojë regjistrimin, për arsye teknike që vijnë nga konventat, një anije të regjistruar në Shtetet Anëtare të BE-së, e cila është në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe ka certifikata të vlefshme dhe pajisje të miratuara ose të markës së certifikuar në përputhje me kërkesat teknike mbi pajisjet detare.

2. Pavarësisht nenit 1, Regjistri, në mënyrë që të përmbushë çdo detyrim sipas instrumenteve mjedisore rajonale të ratifikuara para 1 janarit 1992, mund të vendosë rregulla shtesë, në përputhje me anekset përkatëse të konventave.

3. Pas kërkesës për regjistrim në Regjistër të një anije të regjistruar në Shtetin Anëtar të BE-së, Regjistri duhet t'i kërkojë administratës së saj të gjithë informacionin e mundshëm mbi anijen, në veçanti, mbi kushtet dhe pajisjet e saj me një dosje historie të anijes dhe, nëse është e mundur, një listë të përmirësimeve të kërkuara nga humbja e regjistrimit për regjistrimin e anijes ose rinovimin e certifikatave të saj dhe inspektimet që u ka kaluar afati.

4. Përpara regjistrimit të një anijeje, Regjistri ose një subjekt i autorizuar që vepron në emër të tij, realizon një inspektim në anije, për të konfirmuar që kushtet aktuale të anijes dhe pajisjet e saj i korrespondojnë certifikatave të paraqitura.

5. Nëse, pas inspektimit dhe pasi i ka dhënë pronarit të anijes një mundësi të arsyeshme për të korrigjuar çdo mangësi të konstatuar, Regjistri ose subjekt i autorizuar që vepron në emër të tij, kur ende nuk është në gjendje të konfirmojë përputhshmërinë me certifikatat, mund të refuzojë regjistrimin e anijes.

#### Neni 54

### Certifikatat

1. Regjistri, ose organizmat e njohur që veprojnë në emër të saj, do t'i lëshojnë certifikatat anijes sipas kushteve të njëjta si ato nën flamurin e Shtetit Anëtar të BE-së, nga ku humbet regjistrimin, me kusht që arsyet apo kërkesat që Shteti Anëtar humbës i regjistrimit ka vendosur ose ka bërë ndonjë përjashtim ose heqje dorë të përkohshme të vazhdojnë të zbatohen.

2. Në rast të rinovimit, zgjatjes apo rishikimit të certifikatave, Regjistri, ose organizmat e njohur që veprojnë në emër të saj, nuk do t'i vendosin kërkesa të ndryshme nga ato të përshkruara në fillim për certifikatat me cikël të plotë vlefshmërie për sa kohë që kërkesat dhe kushtet për anijet ekzistuese mbeten të pandryshuara.

#### Neni 55

### Refuzimi i transferimit

Nëse Regjistri e konsideron që një anije nuk mund të regjistrohet në zbatim të nenit 54 për arsye që lidhen me një rrezik serioz mbi sigurinë e anijes apo ndorjen e detit, atëherë mund të bëjë pezullimin e regjistrimit.

Në rastet kur ka divergjenca interpretimesh mbi kërkesat e Konventës apo legjislacionit evropian në këtë fushë, Regjistri do të lajmërojë menjëherë Komisionin për çdo refuzim të lëshimit apo autorizimin për lëshimin e certifikatave të reja të anijes.

#### Neni 56

### Anijet shqiptare

Nëse një anije shqiptare do të regjistrohet në një regjistër të një Shteti anëtar të BE-së, kur kërkohet nga administrata e atij shteti, për të dhënë dokumentet e anijes, Regjistri duhet të veprojë në përputhje me rregulloret e BE-së mbi transferimin e regjistrimit të anijes.

## KREU IX

### KONTRATA BAREBOAT

#### Neni 57

### Regjistrimi i mjetit lundrues me kontratë bareboat

1. Regjistri mund të regjistrojë në regjistrin përkatës dhe i jep të drejtën për të mbajtur flamurin shqiptar një anije të kontraktuar me kontratë "*bareboat*" në Shqipëri, për periudhën e asaj kontrate.

2. Në rastin e një anijeje me kontratë *bareboat*, kontraktuesi do të konsiderohet operator; sidoqoftë nuk do të ketë ndikim në përfitimin e ndonjë të drejte mbi pronësinë e anijes të marrë me qira më shumë se ato të përcaktuara në kontratën specifike të qiramarrjes së anijes me *bareboat*.

3. Një anije me kontratë *bareboat* dhe mbajtëse e flamurit shqiptar, në vijim të paragrafëve 1 deri në 2 të këtij neni do të jetë subjekt i të njëjtit juridiksion të plotë dhe kontroll si anijet e tjera shqiptare.

4. DPD-ja duhet të njoftojë ish-shtetin, flamurin e së cilës mbante anija për regjistrimin dhe në përfundim, për mbylljen e regjistrimit të anijes me kontratë *bareboat*.

## Neni 58

**Kualifikimi dhe e drejta për regjistrimin e një anijeje qiramarrëse *bareboat* përveç anijeve të peshkimit**

Personat e kualifikuar për të qenë pronarë të anijeve shqiptare sipas nenit 8, që marrin me qira një anije (përveç anijeve të peshkimit) me kushtet e qiramarrjes *bareboat*, do të kualifikohen për të regjistruar një qiramarrje *bareboat*.

## Neni 59

**Kualifikimi dhe e drejta për regjistrimin e një anijeje peshkimi me kontratë *bareboat***

1. Personat e përshkruar nga neni 8, që marrin me qira një anije peshkimi me kushtet e një kontrate qiramarrje *bareboat*, kanë të drejtë ta regjistrojnë atë në Regjistër.

2. Një anije peshkimi nuk do të regjistrohet në Regjistër po të mos menaxhohet, dhe veprimtaria e saj kontrollohet dhe drejtohet nga brenda Shqipërisë.

## Neni 60

**Aplikimet**

1. Aplikimi për regjistrimin e një anijeje me kontratë *bareboat* do të kryhet pranë Regjistrimit.

2. Në këtë kapitull, në rast regjistrimi, neni 14 (aplikuesi) do të zbatohet sikur kontraktuesi të jetë pronari.

3. Çdo aplikim për regjistrimin e anijes do të bëhet sipas shtojcës II dhe do të shoqërohet nga:

- a) një deklaratë vërtetimi që do të përfshijë:
  - i) një deklaratë nga çdo kontraktues, duke përcaktuar kualifikimet e tij për të regjistruar një anije me kontratë *bareboat*; dhe
  - ii) në lidhje me anijet e peshkimit, një deklaratë që administrimi dhe drejtimi, e kontrolli i anijes do të kryhen nga brenda Shqipërisë.
- b) Një kopje të kontratës së qiramarrjes që tregon:
  - i) emrin e anijes;
  - ii) emrin e qiramarrësit ose qiramarrësve dhe emrin e pronarit ose pronarëve të anijes;
  - iii) datën e kontratës së qiramarrjes;
  - iv) kohëzgjatjen e kontratës së qiramarrjes;
- c) një certifikatë regjistrimi, ose dokument tjetër të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për regjistrimin e anijeve në vendin e regjistrimit fillestar, që tregon pronësinë e anijes;
- c) certifikatë çregjistrimi/ose deklaratë nga titullari i regjistrimit ekzistues, ku thuhet se mjeti lundrues nuk ka pengesa ligjore apo teknike të bëjë regjistrim të përkohshëm në flamurin Shqiptar për shkak të kontratës të lidhur me *bareboat*; dhe

d) nëse qiramarrësi është një degë kompanie, dokumentin ose dokumentet e kërkuara nga neni 16 (aplikimet nga kompanitë dhe degët e tyre).

## Neni 61

**Refuzimi për të regjistruar një anije peshkimi**

Regjistri mund të refuzojë çdo anije peshkimi si anije me kontratë *bareboat* nëse nuk sigurohet që anija ka çdo certifikatë të kërkuar sipas Rregullores së Anijeve të Peshkimit.

## Neni 62

**Emrat**

1. Në kryerjen e një aplikimi për regjistrimin e një anije, qiramarrëse *bareboat*, aplikuesi duhet të propozojë një emër me të cilën do të thirret anija kur të regjistrohet.

2. Nëse Regjistri sigurohet që emri është në përputhje me kërkesat e shtojcës I, e miraton atë.

## Neni 63

**Numri i identifikimit dhe porti i regjistrimit**

Gjatë kryerjes së aplikimit për regjistrimin e anijes me kontratë *bareboat*, Regjistri do t'i caktojë numrin zyrtar sipas parashikimeve të nenit 20 të kësaj rregulloreje.

## Neni 64

**Shënjimi**

Me regjistrimin e mjetit lundrues me kontratë *bareboat* pronari duhet:

1. të bëjë gdhendjet sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje;
2. nëse kërkohet, të lejojë inspektimin nga Regjistri të gdhendjeve dhe shenjzimit.

## Neni 65

**Regjistrimi**

1. Nëse Regjistri është siguruar për sa i përket një aplikimi që:

- a) anija ka të drejtë të regjistrohet si anije shqiptare me kontratë *bareboat*; dhe
- b) anija është gdhendur siç duhet dhe përllogaritjet e tonazhit ose certifikata e tonazhit dhe certifikatat statutorë janë siguruar; dhe
- c) veçoritë e dhëna të anijes janë të sakta, dhe
- ç) kontrata origjinale e qiramarrjes me *bareboat* të anijes është dorëzuar; dhe
- d) certifikatë çregjistrimi ose deklaratë nga titullari i regjistrimit ekzistues, ku thuhet se mjeti lundrues nuk ka pengesa ligjore apo teknike të bëjë regjistrim të përkohshëm në flamurin shqiptar për shkak të kontratës të lidhur me *bareboat*; dhe

e) kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje janë përmbushur, Regjistri do ta regjistrojë anijen duke regjistruar në Regjistër të dhënat e saj, pronarëve dhe kontraktuesve operatorë siç specifikohen në shtojcat e kësaj Rregulloreje.

2. Me regjistrimin e anijes, Regjistri lëshon dhe i dorëzon qiramarrësit certifikatën e regjistrimit me kontratë *bareboat* që përmban veçantitë e përcaktuara në shtojcën VI.

3. Regjistri mund të mos pranojë të regjistrojë mjetin lundruar me kontratë *bareboat* kur nuk plotësohen kërkesat në paragrafin 1, kërkon informacione sipas nenit 84.

4. Pavarësisht nëse një anije ka në çdo lloj mënyre tjetër të drejtën për t'u regjistruar, Regjistri mund të refuzojë ta regjistrojë atë, duke marrë në konsideratë çdo kërkesë në lidhje me kushtet e anijes ose pajisjeve të saj përsa i përket sigurisë apo rrezikut të ndotjes, apo sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së personave të punësuar apo të angazhuar në bordin e anijes, dhe e konsideron që regjistrimi i anijes do të ishte i pavend.

#### Neni 66

##### **Periudha e regjistrimit**

1. Regjistrimi i një anije qiramarrëse me kontratë *bareboat* do të përfundojë:

a) me përfundimin e periudhës së qiramarrjes;  
b) periudha e qiramarrjes me një kontratë *bareboat* nuk mund të jetë me kohëzgjatje më shumë se 2 (dy) vjet.

2. Tre (3) muaj para skadimit të periudhës së regjistrimit, Regjistri duhet t'i lëshojë qiramarrësit të anijes një njoftim rinovimi.

3. Aplikimi për rinovimin e regjistrimit mund të bëhet gjatë tre muajve të fundit kalendarikë të periudhës aktuale të regjistrimit.

4. Aplikimi duhet të bëhet sipas shtojcës II dhe do të shoqërohet nga një deklaratë vërtetimi dhe certifikatën aktuale të regjistrimit me kontratë *bareboat*.

#### Neni 67

##### **Njoftimi i ndryshimeve**

1. Në qoftë se në çdo kohë, për sa i përket një anijeje qiramarrëse *bareboat*, ndodh ndonjë ndryshim që ndikon në të drejtën e anijes për t'u regjistruar, qiramarrësi i anijes, sa më shpejt të jetë e mundur, të njoftojë Regjistrin.

2. Njoftimi i bërë sipas paragrafit 1 do të bëhet me shkrim, do të nënshkruhet nga kontraktuesi dhe do të specifikojë natyrën e ndryshimit dhe emrin dhe numrin identifikues të anijes.

3. Çdo person që shkel paragrafin 1 zbatohen sanksionet e parashikuara nga legjisllacioni në fuqi.

#### Neni 68

##### **Aplikimi i rregullave të tjera për këtë pjesë**

Do të zbatohen për këtë kapitull neni 35 (Ndryshimi në veçantitë e regjistruara të anijes), Neni 36 (Ndryshimi i emrit).

#### Neni 69

##### **Njoftimi nga Drejtoria e Përgjithshme Detare për Regjistrat e Huaj**

2. DPD-ja do të njoftojë autoritetin përgjegjës për regjistrimin e anijeve në vendin e regjistrimit fillestar kur:

a) anija është regjistruar si anije me kontratë *bareboat* në Regjistrin Shqiptar;

b) regjistrimi i anijes është mbyllur për shkak të skadimit të afatit të certifikatës së regjistrimit sipas nenit 66 (1) (b) (Periudha e regjistrimit);

c) regjistrimi i anijes është mbyllur nga Regjistri si pasojë e nenit 70 (Mbyllja e regjistrimit të anijes me kontratë *bareboat* nga Regjistri).

#### Neni 70

##### **Mbyllja e regjistrimit të anijes qiramarrëse *bareboat* nga zyra e regjistrimit**

1. Regjistri, sipas nenit 80 (Njoftimi), mund të mbyllë regjistrimin e një anije me kontratë *bareboat*:

a) më kërkesën e qiramarrësit/kontraktuesit;  
b) nëse anija nuk ka më të drejtë të regjistrohet;  
c) nëse anija shkatërrohet (që përfshin, por nuk kufizohet në, mbyrtjen, skrapimin, shkatërrimin, djegien e anijes);

ç) nëse e gjykon që regjistrimi i anijes do të ishte i pavend duke marrë parasysh kërkesat në lidhje me kushtet e një anijeje ose pajisjeve të saj për sa i përket sigurisë apo rrezikut të ndotjes, apo sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së personave të punësuar apo të angazhuar në bordin e anijes.

2. Me mbylljen e regjistrimit të anijes sipas paragrafit 1, qiramarrësi do t'i dorëzojë menjëherë Regjistrin certifikatën e regjistrimit të mjetit lundruar me kontratë qiramarrëse *bareboat* për anulim.

#### KREU X

##### **REGJISTRIMI I MJETEVE LUNDRUESE TË VOGLA**

#### Neni 71

##### **Kualifikimet për t'u regjistruar në regjistrin e mjeteve lundruese të vogla**

3. Kanë të drejtë për t'u regjistruar në regjistrin e mjeteve lundruese të vogla, mjetet lundruese si më poshtë:

a) Jahte, skafe, dhe mjete të tjera lundruese të vogla me gjatësi nën 15 metra.

## Neni 72

**Pronarët e një mjeti të vogël lundrimi**

Gëzojnë të drejtën për t'u kualifikuar si pronarë të mjeteve të vogla lundruese, personat dhe shoqëritë e përshkruara në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

## Neni 73

**Aplikimet**

Aplikimet do të bëhen sipas shtojcës XI që shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Fatura e shitblerjes së mjetit të vogël lundrues;
- b) Dokumentacionin e përshtatshmërisë teknike të mjetit lundrues;
- c) Dokumentacionin e regjistrimit të personit fizik apo juridik, sipas rastit.

## Neni 74

**Detajet që do të regjistrohen**

1. Me marrjen e aplikimit për regjistrimin dhe me sigurinë që mjeti i vogël lundrues mund të regjistrohet në mënyrën e duhur dhe emri është në përputhje me shtojcën I, Regjistri do të regjistrojë mjetin e vogël lundrues duke hedhur në Regjistër të dhënat e mëposhtme:

- a) Emrin e mjetit të vogël lundrues;
- b) Numrin e regjistrimit të mjetit të vogël lundrues;
- c) Datën e regjistrimit;
- ç) Të dhënat teknike të mjetit të vogël lundrues;
- d) Të dhënat e pronarit të mjetit të vogël lundrues.

## Neni 75

**Leja e lundrimit për mjetet e vogla lundruese**

Me regjistrimin mjetit të vogël lundrues, Regjistri do të lëshojë një leje lundrimi e cila do të përmbajë detajet e hedhura në Regjistër në përputhje me nenin 74 (Detajet që do regjistrohen), së bashku me adresën e pronarit.

## Neni 76

**Shënjimi**

4. Personi i regjistruar si pronari i mjetit lundrues të vogël duhet të sigurojë që:

- a) pas regjistrimit të mjetit të vogël lundrues të ketë lyer ose të ketë fiksuar në sipërfaqen e jashtme të mjetit të vogël lundrues emrin dhe numrin e saj të regjistrimit, ky lloj shënjimi duhet të mirëmbahet.

## Neni 77

**Zgjatja e afatit**

1. Mjetet e vogla lundruese inspektohen për përshtatshmërinë teknike për çdo vit.

2. Dokumentacioni i përshtatshmërisë teknike është kusht për zgjatjen e afatit të lejes së lundrimit për mjetet e vogla lundruese.

## Neni 78

**Njoftimi për ndryshimin e pronësisë**

1. Pronari i një mjeti të vogël lundrues të regjistruar sipas kësaj pjese, duhet të njoftojë sa më parë të jetë e mundur regjistrimin për:

a) çdo ndryshim që ndikon të drejtën e mjetit të vogël lundrues për t'u regjistruar si mjet lundrues shqiptar; ose

b) çdo ndryshim në lidhje me pronësinë dhe adresën e tyre për mjetin e vogël lundrues; ose

c) çdo detaj në lidhje me ndryshimet teknike të mjetit të vogël lundrues.

2. Njoftimet e bëra sipas paragrafit 1 duhet të bëhen me shkrim, nënshkruhen nga pronari i regjistruar dhe do të specifikojnë natyrën e ndryshimeve, emrin dhe numrin e mjetit.

## Neni 79

**Mbyllja e regjistrimit**

4. Regjistri, në varësi të nenit 80 (Njoftimet) mund të mbyllë regjistrimin e një mjeti të vogël lundrues në rrethanat e mëposhtme:

a) Me kërkesën e pronarit;

b) Kur mjeti i vogël lundrues humbet të drejtën të regjistrohet;

c) Me shkatërrimin e mjetit të vogël lundrues (që përfshin, por nuk kufizohet në, mbytjen, shkatërrimin, djegien, etj).

5. Nëse regjistrimi i mjetit të vogël lundrues mbyllet, leja e lundrimit do të bëhet e pavlefshme dhe duhet të dorëzohet tek Regjistri.

**KREU XI  
TË NDRYSHME**

## Neni 80

**Njoftimet**

1. Nëse Regjistri konstaton se preket ndonjë prej dispozitave të heqjes nga Regjistri (neni 37) ose për mbylljen e regjistrimit të anijes me kontratë *bareboat* (neni 70), ajo njofton pronarin ose pronarin administrues, ose çdo kontraktor, menaxher ose operator të anijes duke i kërkuar që brenda 30 ditëve të paraqesë prova që anija ka të drejtë të qëndrojë në Regjistër.

2. Nëse me skadimin e periudhës 30-ditore Regjistri nuk është plotësisht e siguruar, ajo:

a) mund të zgjasë njoftimin dhe të kërkojë informacione apo prova të tjera shtesë; ose

b) mund të bëjë një njoftim përfundimtar që mbyll regjistrimin e anijes, mbyllje që do të hyjë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas dhënies së njoftimit në adresën e regjistruar.

3. Nëse regjistrimi i anijes mbyllet sipas paragrafit 2, Regjistri do të lëshojë një transkript mbylljeje dhe pronari i anijes duhet të dorëzojë menjëherë certifikatën e regjistrimit.

Neni 81

#### **Kopje e njoftimit për t'iu përcjellë kreditorit**

Nëse Regjistri dërgon një njoftim sipas nenit 80 pronarit të anijes për të cilën është vënë një hipotekë apo barrë sigurues financiare, një kopje të atij njoftimi Regjistri do t'ia përcjellë edhe kreditorit në adresën e regjistruar për të në Regjistër.

Neni 82

#### **Gjuha e dokumentacionit për aplikim**

Çdo dokument përveç dokumentacionit teknik, i cili nuk është në gjuhën shqipe dhe paraqitet në mbështetje të çdo aplikimi sipas kësaj rregulloreje, do të shoqërohet me një përkthim të noterizuar të dokumentit në gjuhën shqipe.

Neni 83

#### **Përfashtimi nga deklaratimet**

5. Nëse sipas kësaj rregulloreje:

a) një personi i kërkohet të bëjë një deklaratë në emër të vetes ose të ndonjë dege kompanie, por nuk është në gjendje ta bëjë këtë dhe Regjistri bindet që ka arsye të besueshme për këtë, Regjistri, me këto kushte, mund të heqë dorë nga deklarata; ose

b) Çdo provë e kërkuar të paraqitet tek Regjistri, por kjo provë nuk mund të paraqitet dhe Regjistri sigurohet për arsyet e besueshme, Regjistri me paraqitjen e provave të tjera që i cilëson të përshtatshme, mund të heqë dorë nga këto prova.

Neni 84

#### **Kërkesat për informacione shtesë**

Nëse nuk sigurohet me informacionin e paraqitur në një aplikim për regjistrimin e një anije, Regjistri mund të kërkojë informacione ose prova të tjera shtesë që i konsideron të përshtatshme.

Neni 85

#### **Taksat**

Kur është parashikuar një taksë në lidhje me ndonjë shërbim ose veprim tjetër për t'u kryer sipas kësaj Rregulloreje, Regjistri nuk do të kryejë asnjë shërbim apo veprim nëse nuk është paguar taksa respektive.

Neni 86

#### **Certifikatatë dublikatë**

1. Nëse Regjistri sigurohet që certifikata e regjistrimit ka humbur, është vjedhur ose prishur, ose 5058

është fshirë apo është bërë e palexueshme (ngjarja), ajo mund t'i lëshojë pronarit një dublikatë të kësaj certifikate, e cila do të shënohet si e tillë dhe do të ketë të njëjtën vlerë si origjinali.

2. Nëse lëshohet një certifikatë regjistrimi dublikatë dhe nëse origjinali më vonë gjendet ose rikuperohet, ajo do të dorëzohet menjëherë tek Regjistri nga pronari i anijes.

3. Nëse porti ku ndodh ngjarja, nuk është në Shqipëri, kapiteni i anijes është i detyruar të përgatisë një raport për ngjarjen, ta nënshkruajë dhe ta firmosë atë, për t'ia përcjellë Regjistrimit me fax, e-mail ose postë. Pronari i anijes, ose personi i autorizuar prej tij, paraqitet pranë regjistruarit, ku bën deklaratën përkatëse. Origjinali i raportit të përgatitur nga kapiteni, duhet dorëzuar brenda një kohe të arsyeshme pranë Regjistrimit.

4. Me marrjen e raportit të kapitenit dhe deklaratës së pronarit të mjetit lundrues dhe sigurimin që anijes i takon e drejta t'i lëshohet një certifikatë dublikatë, Regjistri i dorëzon pronarit të mjetit lundrues certifikatën dublikatë.

Neni 87

#### **Ruajtja e certifikatës**

1. Certifikata e regjistrimit do të përdoret vetëm për lundrimin e ligjshëm të anijes dhe nuk do t'i nënshtrohet ndalimit për shkak të çdo titulli, penglënijeje si garanci page, ndryshimit apo interesave të çfarëdoshme të dhëna apo të pretenduara nga çdo pronar, kreditor apo person tjetër mbi dhe për anijen.

2. Nëse ndonjë person refuzon të dorëzojë pranë Regjistrimit certifikatën e regjistrimit, kur ajo është në posedim të tij, atëherë zbatohen sanksionet e parashikuara në Kodin Detar, neni 387, germa "dh".

Neni 88

#### **Dorëzimi i certifikatës me mbylljen ose skadimin e regjistrimit**

Me mbylljen ose me skadimin e afatit të periudhës së regjistrimit, certifikata e regjistrimit duhet të kthehet nga pronari ose qiramarrësi tek Regjistri për anulim.

KREU XII

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 89

#### **Përkufizime për këtë kapitull**

Për qëllimet e këtij kapitulli:

a) Certifikatë e re: do të thotë një certifikatë regjistrimi e lëshuar në përputhje me këtë rregullore;

b) Certifikatë e vjetër: do të thotë çdo certifikatë regjistrimi, e ndryshme nga certifikata e përkohshme, e lëshuar sipas legjislacionit të mëparshëm në fuqi.

Neni 90

### Vlefshmëria e certifikatave të vjetra

1. Një certifikatë e vjetër do të ngelet në fuqi deri kur:

a) me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, brenda një afat prej 1 (një) viti të paraqiten për zëvendësimin e certifikatës së vjetër me të re; ose

b) ka ndryshime në certifikatën e vjetër para afatit të paraqitur në pikën “a” të këtij neni.

2. Një certifikatë regjistrimi e përkohshme do të jetë e vlefshme deri në datën e skadimit në përputhje me legjislacionin sipas të cilit ka qenë lëshuar.

### SHTOJCA 1

#### MIRATIMI I EMRAVE

1. Çdo aplikim drejtuar zyrës së regjistrimit për të miratuar një emër do të specifikojë një emër i cili do të jetë në germa latine dhe çdo numër do të jetë në numra romak ose europian.

2. Zyra e regjistrimit nuk do ta miratojë emrin e propozuar nëse ai është:

a) një emër ekzistues i një anijeje të regjistruar shqiptare; ose

b) një emër kaq i ngjashëm me një anije të regjistruar shqiptare që vlerësohet se mund të ngatërrohet;

c) një emër që mund të ngatërrohet me një sinjal rreziku;

ç) një emër që ka parashtesë germa ose emra që mund të merren si tregues të tipit të anijes ose çdo lloj emri, para ose prapashtesë që mund të shkaktojë ngatërresë me emrin e anijes.

3. Zyra e regjistrimit, gjithashtu, mund të refuzojë të miratojë një emër që mund të shkaktojë fyerje ose të vërë në siklet.

4. Zyra e regjistrimit mund të lejojë rezervimin e një emri ose caktimi emri të anijes për një periudhë 10-vjeçare nëse sigurohet që:

a) anija ka për qëllim të zëvendësojë një tjetër me të njëjtin emër që do të regjistrohet brenda 10 vjetëve nga data e aplikimit, dhe

b) aplikuesi është pronari i anijes së regjistruar me të njëjtin emër si ai që do të rezervohet dhe legjislacioni i saj Shqiptar do të mbyllet përpara regjistrimit të anijes së re, ose

c) aplikuesi është pronari i anijes së regjistruar me të njëjtin emër si ai që do të rezervohet dhe do të shitet përpara regjistrimit të anijes së re me kusht që ajo të ndërrojë emrin dhe që emri i saj të ndryshojë.



**SHTOJCA 2**  
**APLIKIM PËR REGJISTRIM MJETI LUNDRUES**  
**Pjesa 1. Lloji dhe data e regjistrimit**

Ndërtim i ri    Regjistrim fillestar    Regjistrim i përhershëm    Rinovim    Regjistrim me kontratë bareboat

Data e parashikuar e regjistrimit	dd/mm/vvvv	/ /
-----------------------------------	------------	-----

**Pjesa 2. Të dhënat e anijes dhe pronar-it/eve**

01. Emri i ri		02. Numri IMO		03. Emri aktual		04. Flamuri aktual	
05. Lloji i anijes		06. Viti i ndërtimit		07. Ndërtuesi/kantieri		08. Vendi i ndërtimit	
09. Materiali i skafit	10. Kuverta	11. Direke	12. Shoqëria klasifikuese			13. Data dhe vendi i modifikimit	
14. Gjatësia - loa	15. Gjatësia -lbp	16. Gjerësia	17. Lart.	18. Ton. Net	19. Ton. Bruto	20. Peshëngritja (Dët)	
21. Fuqia lëvizëse	22. Numri dhe lloji i motorit kryesor			23. Prodhuesi i motorit			
24. Emri(at) e pronarit (eve)			25. ADRESA		26. NËNSHTETËSIA		27. Përqindja
						TOTALI	100%

(N.q.s. ka me shumë se dy pronarë, bashkëngjitet dokumentacioni përkatës)

**Pjesa 2. Privilegjet hipotekore**

Privilegjet Hipotekore të shënohen në regjistrimin e anijes	<b>PO</b>	<b>JO</b>
---	-----------	-----------

**Pjesa 3. Aplikuesi ose përfaqësuesi**

Emri i plotë dhe adresa e individit ose kompanisë aplikuese ose përfaqësuese (përfshirë detaje të përfaqësimit)	Telefoni	
	Faksi	
	e- Mail	

**Udhëzues :**

Kutia 01 – Emri nën flamurin shqiptar  
Kutia 02 – Lëshuar nga LR-Fairplay  
Kutia 03 – Emri nën flamurin aktual ose nr. skafit (ndërtime të reja)  
Kutia 04 – Flamuri nga ku anija transferohet ose 'ndërtime të reja' kur aplikohet  
Kutia 05 – Sipas deklartimit ose konfirmimit të klasit  
Kutia 06 – Viti i dorëzimit nga kantieri (jo viti i fillimit të ndërtimit)  
Kutia 09 – P.sh. CELIK (mbulon gjithashtu High Tensile or SS)  
Kutia 10 – Vetëm Numri i kuvertave të vazhdueshme  
Kutia 12 – Shoq. Klasifikuese e njohur nga Administrata Detare Shqiptare  
Kutia 13 – Aplikohet vetëm nëse konfirmohet nga dokumentet e klasës  
Kutia 14 – Gjatësia e përgjithshme (LOA)

Kutia 15 – Gjatësia midis pinguleve (LBP) sipas Cert Ndërkomb. Tonazhit(ITC)  
Kutia 16, 17 – Përllogaritur në Metra sipas ITC  
Kutia 18, 19 – sipas ITC  
Kutia 21 – Fuqia maks. Vetëm njësitë e kombinuara të motorit kryesor (Gjeneratorët nuk aplikohen). **KF/ BHP duhet të konvertohen në KW**  
Kutia 22 – Mund të jetë numri ekzakt/ modeli/lloji apo përshkrim i përgjith;  
Kutia 23 – Vetëm emri. Adresa nuk kërkohet  
Kutia 24, 25, 26, 27 – Korporatë shqiptare ose ent i huaj detar  
Nqs KCB – emri i carteruesit *bareboat* që regjistron anijen në Shqipëri (jo pronari në regjistrin aktual)

**VETËDEKLARIM I PRONARIT OSE PERSONIT TË AUTORIZUAR PREJ TIJ**

Unë \_\_\_\_\_ një nënshtetas i \_\_\_\_\_, me banim në \_\_\_\_\_ (shiko shënimin 1), deklaroj ose konfirmoj se, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, që unë jam \_\_\_\_\_ (Shiko Shënimin 2), i autorizuar me shkrim nga \_\_\_\_\_, një kompani e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të \_\_\_\_\_, me seli në \_\_\_\_\_ (shiko shënimin 1), që kjo kompani është ose do të bëhet pronare e anijes me emrin \_\_\_\_\_ dhe numër IMO \_\_\_\_\_, dhe që emri dhe adresa e pronarit(ëve) ose pronarit(ëve) të ardhshëm dhe nënshtetësia e tyre përkatëse dhe aksionet e tyre në pronësinë e anijes është (janë) ashtu siç janë deklaruar në faqen 1 të aplikimit dhe që Kapiteni aktual ose i ardhshëm i anijes në fjalë është urdhëruar ose do të urdhërohet dhe udhëzohet, që me marrjen e certifikatës së regjistrimit të anijes nën flamurin shqiptar dhe dokumenteve të tjera shqiptare, të dorëzojë dokumentacionin e mëparshëm të lëshuar nga Qeveria e \_\_\_\_\_ (shiko shënimin 3) dhe të realizojë markimet e anijes që kërkohen nga Rregullat e Regjistrimit të Anijeve në Republikën e Shqipërisë.

\_\_\_\_\_  
Emri, mbiemri:

**MORA DIJENI**

Nënshkroi dhe firmosi përpara meje

Sot më datë \_\_\_\_\_ (Viti) në Durrës

\_\_\_\_\_  
**Regjistruesi**

Shënime

1. Shënoni adresën e rrugës, qytetin dhe shtetin.
2. Shënoni presidentin, zv/presidentin, drejtorin, sekretarin, autorizuar në fakt, etj kushdo titull i aplikueshëm.
3. Flamuri aktual (shiko kutinë 4, në faqen 1 nga 2)

**SHTOJCA 3**  
**TË DHËNAT NË REGJISTËR DHE FORMATI**

TE DHENAT E ANIJES				TE DHENAT PER MAKINERINE		TE DHENAT PER PRONESINE E ANIJES	
Nr.Zyrtar i Regjistrimit				Motori Kryesor		Pronari dhe Adresa e tij	
Data e Regjistrimit				Tipi			
Emri i Anijes				Sasia		Nr IMO-s për Pronarin	
Kodi/Tipi i Anijes	10- Transport Ngarkesash			Fuqia(Kw)		Fitimi i Pronësisë	
	20- Transport Pasagjerës & Ro-Ro			Rrot/min		Kontrata Bare Boat	
	30- Shërbime Portuale			Viti ndërtimit		Data, Muaji,Viti	
	40- Peshkimi			Vendi ndërtimit		Nënshkrimi i Personit të Autorizuar	
	50- Kërkime Shkencore			Prodhuesi		Hipoteka/Barra Hipotekore	
60- Me Kontratë 'Bareboat'			Motori Ndhmues				
Nr i IMO-s				Tipi		<b>TE DHENAT PER KOMPANINE PERGJEGJESE PER OPERIMIN</b>	
Përmasat	Nr Kuvert.	Nr. Direk.	Nr.Fumajolëve	Sasia		Kompania dhe Adresa e saj	
	Gjatësi		Gjerësi	Fuqia(Kw)		Nr IMO-s për Kompaninë	
			Lart.konstruktive	Rrot/min		<b>SHENIME PER NDRYSHIMIN E PRONESISE SE ANIJES</b>	
Tonazhi	TB	TN	DWT	Viti ndërtimit		Pronari dhe Adresa e tij	
			Nr. Pax	Vendi ndërtimit			
Emri i Mëparëshëm				Motori Ndhmues		Nr IMO-s për Pronarin	
Flamuri Mëparëshëm				Tipi		Akti Noterial i Shitblerjes	
Viti ndërtimit				Sasia		Kontrata Bare Boat	
Vendi ndërtimit				Fuqia(Kw)		Data, Muaji,Viti	
Ndërtuesi				Rrot/min		Nënshkrimi i Personit të Autorizuar	
Materiali ndërtimit				Viti ndërtimit		Hipoteka/Barra Hipotekore	
<b>TE DHENAT PER DOSJEN E ANIJES</b>				Vendi ndërtimit		<b>SHENIME PER NDRYSHIMIN E PRONESISE SE ANIJES</b>	
Nr Dosjes				Prodhuesi			
<b>TE DHENAT PER ORGANIZATAT E NJOHURA (RO/RSO)</b>							
Organizata e Njohur						Pronari dhe Adresa e tij	
Adresa						Nr IMO-s për Pronarin	
Organizata e Njohur e Sigurisë						Akti Noterial i Shitblerjes	
Adresa						Kontrata Bare Boat	
Certifikatat e anijes							
1	11					Data, Muaji,Viti	
2	12					Nënshkrimi i Personit të Autorizuar	
3	13					Hipoteka/Barra Hipotekore	
4	14					<b>SHENIME PER NDRYSHIMIN E KOMPANISE SE OPERIMIT</b>	
5	15					Kompania dhe Adresa e saj	
6	16					Nr IMO-s për Kompaninë	
7	17					<b>SHENIME PER NDRYSHIMIN E TE DHENAVE TE ANIJES</b>	
8	18					Data e Ndryshimit	
9	19						
10	20						
<b>TE DHENAT PER C' RREGJISTRIMIN E ANIJES</b>							
Data dhe Arsyeja e C'rregjistrimit						Data e Ndryshimit	
						Data e Ndryshimit	

<b>KORIGJIMI I GABIMEVE MATERIALE</b>					
<b>NR</b>	<b>DATA E KORIGJIMIT</b>	<b>SI ISHTE</b>	<b>SI BEHET</b>	<b>VEREJTJE</b>	<b>EMRI DHE FIRMA E PERSONIT TE AUTORIZUAR</b>

**SHTOJCA 4**  
**CERTIFIKATA E PËRKOHSHME E REGJISTRIMIT**



REPUBLIC OF ALBANIA  
*Republika e Shqipërisë*  
Ministry of Transport and Infrastructure  
*Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës*  
General Maritime Directorate  
*Drejtoria e Përgjithshme Detare*  
Ship Registry  
*Regjistri i Mjeteve Lundruese*

PROVISIONAL CERTIFICATE OF REGISTRY  
*CERTIFIKATË E PËRKOHSHME E REGJISTRIMIT*  
Issued in accordance with Maritime Code  
*Lëshuar në përputhje me Kodin Detar*

Name of Vessel / *Emri i Anijes* " \_\_\_\_\_ "

Call Sign / <i>Shenja e Thirrjes</i>	IMO No./ <i>Nr. IMO-s</i>	Official No./ <i>Nr. zyrtar</i>	Port of Registry / <i>Porti i regjistrimit</i>
Classification Society and Address/ <i>Shoqëria e klasifikimit dhe Adresa</i>		Company responsible for Operation & Address / <i>Kompania përgjegjëse për operimin &amp; adresa</i>	

**GENERAL DESCRIPTION OF OËNER**  
*PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PRONARIT*

Name of Owner / <i>Emri i pronarit</i>	Residence / <i>adresa</i>	Citizenship / <i>Nënshitetësia</i>	Dt. Recorded/ <i>Dt. regjistrimit</i>	Shares / <i>Aksionet</i>
1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____

**GENERAL DESCRIPTION OF VESSEL**  
*PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ANIJES*

Type of Vessel / <i>Lloji i anijes</i>	Gross Tonnage / <i>Tonazhi bruto</i>	Net Tonnage / <i>Tonazhi Neto</i>	Hull Material / <i>Materiali i skafit</i>	
Vessel Previous Name/ <i>Emri i mëparshëm i anijes</i>	Vessel Previous Nationality / <i>Flamuri i mëparshëm i anijes</i>		Radio Accounting Authority (AAIC) / <i>Autoriteti i Llogarive Detare</i>	
No. of Decks/ <i>Nr. i kuvertave</i>	No. of Masts / <i>Nr. i Direkëve</i>	No. of Funnels / <i>Nr. i Fumajolëve</i>	Length / <i>Gjatësia</i>	Breadth / <i>Gjerësia</i>
Name of Builder / <i>Prodhuesi i anijes</i>		Place / Year of Build / <i>Vendi dhe viti i prodhimit</i>		Depth / <i>Lartësia konstruktive</i>
No./Type/Model of Engine / <i>Nr./Lloji/Modelli i makinës</i>		Name of Engine Maker / <i>Prodhuesi i makinës</i>		Speed / <i>Shpejtësia</i>
			Engine Power / <i>Fuqia motorrike</i>	

Place / Date of Issue / <i>Vendi / Data e lëshimit</i>	Expiry Date / <i>Data e skadimit</i>
_____	_____

The department of Ship Registry of the Albanian Maritime Administration, acting in full pursuant with the Maritime Code, by means of this document, hereby attests that the Oëners of above described vessel have submitted an application and applied to the vessel provisional registered in the Albanian Ship Registry, undertaking to submit the document established by the Maritime Code and respective Regulation of registration of Vessels, for obtaining the Permanent Ship Registry Certificate to be issued to the vessel.  
*Regjistri i Mjeteve Lundruese të Administratës Detare Shqipëtare, duke vepruar në përputhje të plotë me Kodin Detar, me anën e këtij dokumenti, vërteton se pronarët e anijes së sipër përshkruar kanë dorëzuar një kërkesë dhe aplikuar për regjistrimin e përkohshëm në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, duke marrë përsipër që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar nga Kodi Detar dhe respektivisht nga Rregulloja e regjistrimit të mjeteve lundruese, për të përfutur Certifikatën e Përhershme të Regjistrimit që i lëshohet anijes.*

\_\_\_\_\_  
**Authorized Officer / *Personi i autorizuar***

**SHTOJCA 5**  
**CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT**



**REPUBLIC OF ALBANIA**  
*Republika e Shqipërisë*  
**Ministry of Transport and Infrastructure**  
*Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës*  
**General Maritime Directorate**  
*Drejtoria e Përgjithshme Detare*  
**Ship Registry**  
*Regjistri i Mjeteve Lndruese*

**CERTIFICATE OF REGISTRY**  
**CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT**  
Issued in accordance with Maritime Code  
*Lëshuar në përputhje me Kodin Detar*

Name of Vessel / Emri i anijes " \_\_\_\_\_ "

Call Sign / Shenja e thirrjes _____	IMO No./ Nr. IMO-s _____	Official No./ Nr. zyrtar _____	Port of Registry / Porti i regjistrimit _____
Classification Society and Address / Shoqëria e klasifikimit dhe Adresa _____		Company responsible for Operation & Address / Kompania përgjegjëse për operimin & adresa _____	

**GENERAL DESCRIPTION OF OËNER**  
**PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PRONARIT**

Name of Owner / Emri i pronarit 1. _____ 2. _____	Residence / Adresa 1. _____ 2. _____	Citizenship/ Nënshetësia 1. _____ 2. _____	Dt. Recorded / Dt. regjistrimit 1. _____ 2. _____	Shares / Aksionet 1. _____ 2. _____
---	--	--	---	---

**GENERAL DESCRIPTION OF VESSEL**  
**PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ANIJES**

Type of Vessel / Lloji i anijes _____	Gross Tonnage / Tonazhi bruto _____	Net Tonnage / Tonazhi neto _____	Hull Material / Materiali i skafit _____
Vessel Previous Name / Emri i mëparshëm i anijes _____	Vessel Previous Nationality / Flamuri i mëparshëm i anijes _____		Radio Accounting Authority (AAIC) / Autoriteti i Llogarive Detare _____
No. of Decks / Nr. i Kuvertave _____	No. of Masts / Nr. i direkëve _____	No. of Funnels / Nr. i fumajolëve _____	Length / Gjatësia _____
Breadth / Gjerësia _____		Depth / Lartësia konstruktive _____	
Name of Builder / Prodhuesi i anijes _____	Place / Year of Build / Vendi dhe viti i prodhimit _____		Navigational Area / Rajoni i lundrimit _____
No. / Type / Model of Engine / Nr. / Lloji / Modeli i makinës _____	Name of Engine Maker / Prodhuesi i makinës _____		Speed / Shpejtësia _____
Engine Power / Fuqia motorrike _____		_____	

Place / Date of Issue / Vendi / Data e lëshimit \_\_\_\_\_

Expiry Date / Data e skadimit \_\_\_\_\_

Whereas, the Department of Ship Registry of the Albanian Maritime Administration, acting in full pursuant to the Maritime Code, by means of this document, hereby attests that has considered and approved the applications of the Owners of above described vessel. Therefore, be it resolved, that there be issued, pursuant to the terms of the Albanian Maritime Code and Registry Regulation respectively, this Certificate of Registry to the said vessel entitling her to engage in foreign trade under the Flag of Republic of Albania and be accorded to the rights and privileges of a Albanian vessel in accordance with terms of the Maritime.

Regjistri i Mjeteve Lndruese të Administratës Detare Shqipëtare, duke vepruar në përputhje të plotë me Kodin Detar, me anën e këtij dokumenti, vërteton se ka marrë parasysh dhe miratuar kërkesën dhe aplikimin e Pronarëve të anijes së sipër përshkruar. Për këtë, konsiderohet e zgjidhur, lëshimi i kësaj Certifikate të Regjistrimit për anijen e sipër përshkruar, duke i dhënë asaj të drejtën e lundrimit ndërkombëtar nën Flamurin Shqiptar në përputhje me kërkesat e Kodit Detar Shqiptar dhe respektivisht me rregulloren e Regjistrimit dhe i akordohen të drejtat dhe privilegjet e anijes Shqiptare në përputhje me termat e Detarisë.

Authorized Officer / Personi i autorizuar \_\_\_\_\_

**SHTOJCA 6**  
**CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT ME KONTRATË 'BAREBOAT'**



**REPUBLIC OF ALBANIA**  
*Republika e Shqipërisë*  
**Ministry of Transport and Infrastructure**  
*Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës*  
**General Maritime Directorate**  
*Drejtoria e Përgjithshme Detare*  
**Ship Registry**  
*Regjistri i Mjeteve Lundruese*

**CERTIFICATE OF REGISTRY**  
**Under Bareboat Charter**  
**CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT**  
**Me Kontratë 'Bareboat'**  
Issued in accordance with Maritime Code  
*Lëshuar në përputhje me Kodin Detar*

<b>Call Sign / Shenja e thirrjes</b> _____	<b>IMO No./ Nr. IMO-s</b> _____	<b>Official No./ Nr. zyrtar</b> _____	<b>Port of Registry / Porti i regjistrimit</b> _____		
<b>Classification Society and Address/ Shoqëria e klasifikimit dhe adresa</b> _____		<b>'Bareboat' Chartering Company &amp; Address / Kompania qermarrëse me kontratë 'bareboat' &amp; adresa</b> _____			
<b>GENERAL DESCRIPTION OF OËNER</b> <i>PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PRONARIT</i>					
<b>Name of Owner / Emri i pronarit</b> 1. _____ 2. _____	<b>Residence / Adresa</b> 1. _____ 2. _____	<b>Citizenship/ Nënshetësia</b> 1. _____ 2. _____	<b>Dt. Recorded/ Dt. regjistrimit</b> 1. _____ 2. _____	<b>Shares / Aksionet</b> 1. _____ 2. _____	
<b>GENERAL DESCRIPTION OF VESSEL</b> <i>PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ANIJES</i>					
<b>Type of Vessel / Lloji i anijes</b>	<b>Gross Tonnage / Tonazhi bruto</b>	<b>Net Tonnage/ Tonazhi neto</b>	<b>Hull Material / Materiali i skaftit</b>		
<b>Vessel Previous Name/ Emri i mëparshëm i anijes</b>	<b>Vessel Previous Nationality / Flamuri i mëparshëm i anijes</b>		<b>Radio Accounting Authority (AAIC) / Autoriteti i Llogarive Detare</b>		
<b>No. of Decks / Nr. i Kuvartave</b>	<b>No. of Masts/ Nr. i direkëve</b>	<b>No. of Funnels / Nr. i fumajolëve</b>	<b>Length / Gjatësia</b>	<b>Breadth / Gjerësia</b>	<b>Depth / Lartësia konstruktive</b>
<b>Name of Builder / Prodhuesi i anijes</b>	<b>Place / Year of Build / Vendi dhe viti i prodhimit</b>		<b>Navigational Area / Rajoni i lundrimit</b>		
<b>No./Type/Model of Engine / Nr./Lloji/Modeli i makinës</b>	<b>Name of Engine Maker / Prodhuesi i makinës</b>		<b>Speed / Shpejtësia</b>	<b>Engine Power / Fuqia motorrike</b>	
<b>Place / Date of Issue / Vendi / Data e lëshimit</b> _____			<b>Expiry Date / Data e skadimit</b> _____		

The Department of Ship Registry of the Albanian Maritime Administration, acting in full pursuant to the Maritime Code, by means of this document, hereby attests that the Oëners of above described vessel have submitted an application to the Albanian Ship Registry under Bare Boat Charter and their application is considered approved. Therefore, be it resolved, that there be issued, pursuant to the terms of the Albanian Maritime Code and Registry Regulation respectively, this Certificate of Registry under Bareboat Charter to the said vessel entitling her to engage in foreign trade under the Flag of Republic of Albania and be accorded to the rights and privileges of a Albanian vessel in accordance with terms of the Maritime Code under period of validity of this certificate.

*Regjistri i Mjeteve Lundruese të Administratës Detare Shqiptare, duke vepruar në përputhje të plotë me Kodin Detar, me anën e këtij dokumenti, vërteton se Pronarët e anijes së sipër përshkruar kanë dorëzuar një kërkesë në Regjistrin e Mjeteve Lundruese Shqiptare, nën Kontratë Bare Boat dhe kërkesa e tyre është konsideruar e miratuar. Për këtë, konsiderohet e zgjidhur, lëshimi i kësaj Certifikate e Regjistrimit me kontratë 'bareboat' për anijen e sipër përshkruar, duke i dhënë asaj të drejtën e lundrimit ndërkombëtar nën Flamurin Shqiptar duke përfutur kështu të drejtat dhe privilegjet e një anije Shqiptare në përputhje me kërkesat e Kodit Detar Shqiptar për periudhën e vlefshmërisë së kësaj certifikate.*

**Authorized Officer / Personi i autorizuar**

**SHTOJCA 7**  
**EKSTRAKT I RREGJISTRIT**



**REPUBLIC OF ALBANIA**  
*Republika e Shqipërisë*  
**Ministry of Transport and Infrastructure**  
*Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës*  
**General Maritime Directorate**  
*Drejtoria e Përgjithshme Detare*  
**Ship Registry**  
*Regjistri i Mjeteve Lndruese*

**TRANSCRIPT OF REGISTER**  
**EKSTRAKT I REGJISTRIT**  
Issued in accordance with Maritime Code  
*Lëshuar në përputhje me Kodin Detar*

Name of Vessel / Emri i anijes " \_\_\_\_\_ "

Call Sign / Shenja e thirrjes _____	IMO No./ Nr. IMO-s _____	Official No./ Nr. zyrtar _____	Port of Registry / Porti i regjistrimit _____
Classification Society and Address / Shoqëria e klasifikimit dhe adresa _____		'Bareboat' Chartering Company & Address / Kompania qermarrëse me kontratë 'Bareboat' & adresa _____	

GENERAL DESCRIPTION OF OËNER PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PRONARIT				
Name of Owner / Emri i pronarit	Residence / Adresa	Citizenship/Nënshtetësia	Dt. Recorded/Dt. regjistrimit	Shares / Aksionet
1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____
GENERAL DESCRIPTION OF VESSEL PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ANIJES				
Type of Vessel / Lloji i anijes	Gross Tonnage / Tonazhi Bruto	Net Tonnage / Tonazhi Neto	Hull Material / Materiali i skafit	
Vessel Previous Name/ Emri i mëparshëm i anijes	Vessel Previous Nationality / Flamuri i mëparshëm i anijes		Radio Accounting Authority (AAIC) / Autoriteti i Llogarive Detare	
No. of Decks / Nr. i Kuvertave	No. of Masts / Nr. i direktëve	No. of Funnels / Nr. i fumajolëve	Length / Gjatësia	Breadth / Gjerësia
Name of Builder / Prodhuesi i anijes	Place / Year of Build / Vendi dhe viti i prodhimit		Depth / Lartësia konstruktive	
No./Type/Model of Engine / Nr./Lloji/Modeli i makinës	Name of Engine Maker / Prodhuesi i makinës		Speed / Shpejtësia	Engine Power / Fuqia motorrike

Particulars of Encumbrances (if any) and Certification / Veçori të Privelegjeve Hipotekore dhe Vërtetimi \_\_\_\_\_

I hereby certify that the foregoing printed and written particulars are true exact from the Registry Book noë in my charge shoëing the descriptive particulars and oënership of m/v " \_\_\_\_\_", Official Number \_\_\_\_\_.  
THIS TRANSCRIPT DOES NOT SUBSTITUTE THE REGISTRY CERTIFICATE.  
Me anën e kësaj vërtetohet se dokumenti i mësipërm dhe detajet e shkruara janë saktësisht nga Regjistri, tani nën përgjegjësinë time ku pasqyrohen veçoritë përshkruese dhe pronësinë e anijes " \_\_\_\_\_", me numër zyrtar \_\_\_\_\_, KY EKSTRAKT NUK ZËVENDËSON CERTIFIKATËN E REGJISTRIMIT.

Issued today at/Lëshuar sot në Durrës, \_\_\_\_\_

Authorized Officer / Personi i autorizuar



**SHTOJCA 8**  
**APLIKIM PËR NDRYSHIM TË DHËNASH TË MJETIT LUNDRUES**

**EMRI I ANIJES:**

**EMRI I APLIKANTIT/ KOMPANISË:**

ZËRAT	ZËRAT E DETAJUAR PËR NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE (Shkruani më poshtë te zërat, të dhënat e të cilëve ju doni të ndryshoni)	
	I mëparshëm (nga)	I ri (në)
Emri i anijes		
Pronari		
Operatori		
Lloji i anijes		
Tonazhi (BRT/NRT)		
Dimensionet (GJATESI/GJERESI / LARTËSI)		
Aaic (emri & kodi)		
Pajisjet e radios/ Zona e lundrimit		
Rajoni i lundrimit		
Të tjera		

<b>Statusi aktual i regjistrimit</b>	Nr. Cert. Regj. vlefshme	:	_____
	Data e lëshimit	:	_____
	Data e skadencës	:	_____

Data \_\_\_\_\_

Vendi \_\_\_\_\_

Emri i aplikanti & firma

\_\_\_\_\_

**SHTOJCA 9**  
**APLIKIM PËR ÇREGJISTRIMIN E ANJES**

<b>TË DHËNAT E ANJES</b>			
<i>Emri i anijes</i>	<i>Porti i regjistrimit</i>	<i>Numri IMO-s</i>	
<i>Numri zyrtari i regjistrimit</i>	<i>Shenja e thirrjes</i>	<i>Numri MMSI-se</i>	
<b>TË DHËNAT E PRONARIT(eve)</b> (vazhdo në një fletë tjetër n.q.s. duhet)			
Emri i plotë i pronarit(eve) :			
Adresa:	Adresa 1 :		
	Adresa 2 :		Tel :
	Qarku/qyteti :		Faks :
	Kodi postar / Zip :		Email :
	Shteti :	Numri IMO-s i pronarit (n.q.s. njihet)	
<b>Emri i aplikantit:</b> (n.q.s. është i ndryshëm nga pronari)			
<b>ARSYET E ÇREGJISTRIMIT</b> (n.q.s. ndryshohet flamur, ju lutem deklaroni flamurin e ri ku do të regjistrohet)			

*Ne me anë të kësaj ju kërkjmë që anija e lartpërmendur të çregjistrohet nga Regjistri i Mjeteve Lundruese Shqiptare.*

*Emri mbiemri & firma e aplikantit* \_\_\_\_\_

*Data e aplikimit* \_\_\_\_\_

**SHTOJCA 10  
CERTIFIKATA E ÇREGJISTRIMIT**



**REPUBLIC OF ALBANIA**  
*Republika e Shqipërisë*  
**Ministry of Transport and Infrastructure**  
*Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës*  
**General Maritime Directorate**  
*Drejtoria e Përgjithshme Detare*  
**Ship Registry**  
*Regjistri i Mjeteve Lundruese*

**DELETION CERTIFICATE**  
**CERTIFIKATË ÇREGJISTRIMI**  
Issued in accordance with Maritime Code  
*Lëshuar në përputhje me Kodin Detar*

Name of Vessel / Emri i anijes " \_\_\_\_\_ "

Call Sign / Shenja e thirrjes _____	IMO No./ Nr. IMO-s _____	Official No./ Nr. zyrtar _____	Port of Registry / Porti i regjistrimit _____
Classification Society and Address/Shoqëria e klasifikimit dhe adresa _____		'Bareboat' Chartering Company & Address / Kompania qermarrëse me kontratë 'bareboat & adresa _____	

GENERAL DESCRIPTION OF OËNER <i>PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PRONARIT</i>				
Name of Owner / Emri i pronarit	Residence / Adresa	Citizenship/Nënshtetësia	Dt. Recorded/Dt. regjistrimit	Shares / Aksionet
1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____	1. _____ 2. _____

GENERAL DESCRIPTION OF VESSEL <i>PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ANIJES</i>				
Type of Vessel / Lloji i anijes	Gross Tonnage / Tonazhi bruto	Net Tonnage / Tonazhi neto	Hull Material / Materiali i skafit	
Vessel Previous Name / Emri i mëparshëm i anijes	Vessel Previous Nationality / Flamuri i mëparshëm i anijes		Radio Accounting Authority (AAIC) / Autoriteti i Llogarive Detare	
No. of Decks / Nr. i Kuvertave	No. of Masts / Nr. i direkëve	No. of Funnels / Nr. i fumajolëve	Length / Gjatësia	Breadth / Gjerësia
Name of Builder / Prodhuesi i anijes		Place / Year of Build / Vendi dhe viti i prodhimit		Depth / Lartësia konstruktive
Name of Engine Maker / Prodhuesi i makinës		Speed / Shpejtësia		Engine Power / Fuqia motorrike

Particulars of Encumbrances (If any) and Certification / Veçori të privilegjeve hipotekore dhe vertetimi \_\_\_\_\_

I, the Register, hereby confirm that the registration for the above described vessel has ceased being registered on \_\_\_\_\_

Unë, regjistruesi, me anë kësaj certifikate vërtetoj se mjeti lundrues i përshkruar më lart është çregjistruar më \_\_\_\_\_

Issued today at/Lëshuar sot në Durrës, \_\_\_\_\_

Authorized Officer / Personi i autorizuar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 32 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006